



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I LETËRSISË



# Trashëgimia e gazetës “Drita”

Tiranë, 2024

Realizuan kërkimin shkencor:

Prof.Dr. Dhurata Shehri

Prof.Dr. Persida Asllani

Prof.as.dr.Edlira Macaj

Dr. Loreta Loli

Një falënderim i veçantë i shkon **Grupit të Masterit Shkencor**, viti I (viti akademik 2023-2024), përkatësisht studentëve:

*Anisa Krasniqi, Armela Pepaj, Begeza Gërbi, Eleni Nurellari, Iliada Murataj, Kleona Kostreni, Laura Çobo, Nurisa Xhafa, Rubensa Ndreca, Stelina Palushi, Vito Xhiku*, të cilat ndihmuan në vjeljen e zërave bibliografikë më të rëndësishëm të kritikës në faqet e gazetës “Drita”, për një pjesë të periudhës së mbuluar në këtë punim dhe, në mënyrë të veçantë, siguruan fotot ilustruese.

© Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

---

Shtypur në shtypshkronjën **FILARA**

**Adresa:**

Rruga “Sabaudin Gabrani”

Ish-kombinati “Misto Mame”, Tiranë

Cel: 069 33 30 983

E-mail: [filarabotime@yahoo.com](mailto:filarabotime@yahoo.com)

[filarabotime@gmail.com](mailto:filarabotime@gmail.com)

website: [www.filarabotime.com](http://www.filarabotime.com)

## Përmbajtja

1. Parafjalë .....	5
2. Hyrje.....	7
3. Parametrat e studimit (metodologjia) .....	9
4. Shqyrtimi i literaturës.....	11
4.1 Periodikët, rëndësia e tyre .....	11
4.2 Letërsia e realizmit socialist.....	13
4.3 Nga modelimi te implementimi i një realizmi socialist shqiptar në dukje sui generis .....	16
5. Gazeta “Drita” – letërsia dhe ligjërimi mbi të.....	23
5.1 Vitet 1961-1965.....	23
Viti 1961.....	23
Viti 1962.....	27
Viti 1963.....	29
Viti 1964.....	31
Viti 1965.....	32
Rast studimi .....	37
Debati mbi novatorizmin në faqet e gazetës “Drita”.....	37
5.2 Vitet 1966-1970.....	41
Viti 1966.....	41
Viti 1967.....	43
Viti 1969.....	45
Viti 1970.....	46
5.3 Vitet 1971-1975.....	49
Viti 1971.....	49
Viti 1972.....	51
Viti 1973.....	52
Viti 1974.....	53
Viti 1975.....	54
Rast studimi .....	57
Risemantizimi i termit “novatorizëm” dhe realizmi socialist “sui generis” .....	57

5.4 Vitet 1976-1980.....	65
Viti 1976.....	65
Viti 1977.....	65
Viti 1978.....	66
Viti 1979.....	66
Viti 1980.....	67
5.5 Vitet 1981-1990.....	71
Viti 1981.....	71
Viti 1982.....	71
Viti 1983.....	73
Viti 1984.....	74
Viti 1985.....	75
Viti 1986.....	77
Viti 1987.....	78
Viti 1988.....	78
Viti 1989.....	79
Viti 1990 - prag alegorik i ndryshimit.....	80
6. Tabela të përgjithshme për periudhën 1961-1990.....	85
PJESA 2.....	89
Listë artikujsh të shqyrtuar nga gazeta “Drita”, 1961-1990.....	89
Referenca.....	197

## 1. Parafjalë

Projekti *Trashëgimia e gazetës "Drita" në një prezantim multimedial* erdhi si një ide bashkëpunimi midis departamentit të Letërsisë dhe departamentit të Gazetarisë e Komunikimit. Për realizimin e tij u angazhuan gjatë një periudhe 12 mujore pedagogë nga të dyja departamentet, të cilët patën në fokus zbardhjen e mënyrës së receptimit të letërsisë në disa forma: në përthyerjen e saj kritike të shkrimit kritike të gazetës "Drita", - si organi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë; përthyerjen e saj në forma të tjera artistike, siç janë filmat e frymëzuar prej teksteve letrare; si dhe përthyerjen kritike të kulturës në përgjithësi (ç'ndodhte me të) përgjatë periudhës 1945-1990.

Projekti u realizua nën kujdesin e dekanit të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Prof.dr. Sabri Laçi dhe nën drejtimin e Prof.as.dr. Edlira Macaj, me ekspertizë në fushat e teorisë së letërsisë, kritikës dhe antropologjisë kulturore. Nga ana e departamentit të Letërsisë dhanë ndihmën e vyer profesionale Prof.dr. Dhurata Shehri, në cilësinë edhe të ideatores së projektit dhe të zëvendësdekanes së fakultetit, Prof.dr. Persida Asllani, përgjegjëse e departamentit të Letërsisë, si dhe Dr. Loreta Loli, pedagoge dhe specialiste në fushën e Bibliotekonomisë.

Qëllimi i këtij projekti ishte:

- ✓ të fuqizonte kërkimin shkencor në nivel fakulteti;
- ✓ të propozonte një model të ri kërkimi shkencor që sjell rezultate prej kërkimit *ndërdisciplinar* – këtu, si rezultat i bashkëpunimit mes studiuesve të letërsisë dhe ekspertëve të medias dhe komunikimit;
- ✓ të konkretizonte kërkimin në botim shkencor me parametra matës (statistika, grafikë, lista bibliografike, analiza, interpretime, foto etj.), të realizuar nga departamenti i Letërsisë;
- ✓ të konkretizonte kërkimin në një gjuhë multimediale (fotografi, intervista, video, materiale të tjera të regjistruara në audio, hiperlinqe, të dokumentacionit të shfrytëzuar etj.), të realizuar nga departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit;
- ✓ të fuqizonte imazhin akademik të FHF-së, pasi produkte të tilla konkrete, të prekshme dhe të aksesueshme online afrojnë edhe më shumë studentë pranë këtij fakulteti.



## 2. Hyrje

Letërsia shqiptare, kultura shqiptare në përgjithësi, por edhe filmi, si pjesë e kulturës së vendit, në historicitetin e tyre kanë komunikuar me lexuesin e kohës kryesisht nëpërmjet receptimit kritik. Gjendja e kritikës letrare, si dhe e kulturës në përgjithësi të ne, nuk është rezultat i momentit. Ajo vjen si fryt i shenjave e mbishenjave që lë çdo periudhë. Nëse, me marrëveshje për qëllim studimor, mbetemi në një prerje historiko-letrare të periudhave, si: letërsia shqipe para viteve '45 të shekullit të shkuar, letërsia shqipe gjatë regjimit diktatorial në vitet '45-'90 e letërsia shqipe pas viteve '90-të e në vijim, atëherë dhe kritika mbi letërsinë shqipe përfaqëson tri pamje për secilën periudhë.

Karakteristikë e periudhës së parë është që receptimi i letërsisë bëhet nëpërmjet shkrimeve të botuara në periodikët e kohës brenda dhe jashtë Shqipërisë, periodikë që përfshijnë të gjitha llojet e informacioneve, por, mes tyre, edhe gazeta apo revista të fokusuar vetëm te letërsia. Kjo periudhë e parë e receptimit kritik e përthyen letërsinë edhe në gjuhë të tjera (pasi disa periodikë botohen në frëngjisht, italisht etj.) Kjo ndryshe njihet si periudha e paradigmës së debatit konstruktiv në kritikën letrare shqiptare, ku vetë mendimi kritik sapo kishte lindur dhe zhvillohej në këtë medium<sup>1</sup>.

Në periudhën e dytë, përveç periodikëve, këtu specifikisht gazeta "Drita", apo botimeve të veçanta shkencore të konferencave, studimeve, monografive etj., aktivizohet edhe televizioni si medium komunikimi dhe kritike. Përthyerja e letërsisë në filma, rezultoi të ishte një tjetër lloj receptimi kritik e përzgjedhës që i bëhej letërsisë, në përputhje me direktivat ideologjike. Ideologjia komuniste dhe propaganda e saj u bënë baza mbi/me të cilat duhet të gjallonte letërsia e kohës. Megjithatë "Drita" mbeti njëra nga gazetatat më të rëndësishme dhe më me ndikim gjatë gjithë viteve të regjimit.

Në periudhën e tretë, pas viteve 1990-të, kritika manifestoi në fillimet e veta shenjat e ideologjisë dhe të propagandës të ndeshura si dominancë në periudhën pararendëse. Por u shfaqën gjithashtu (mesi i viteve '90-të), edhe shenjat e humbjes së peshës së kritikës në marrëdhënie me objektin letrar që shqyrtonte. Aktorët e kësaj prirjeje janë më së shumti shkrimtarë që kërkojnë të rikonfirmojnë poetikën, brezin

---

<sup>1</sup> Marisa Kërbizi, Edlira Macaj. "Albanian Literature in Its Critical Evaluation Process. Case Study: Periodicals". *Interlitteraria*, 2020, University of Tartu, f. 348.

dhe statusin letrar të tyre të mëparshëm dhe të lidhur me statusin social e politik të letërsisë së realizmit socialist, por pa sukses. Paralel me këtë dukuri shfaqen fillesat e një kritike të re, të diversifikuar në metodë e cila kërkon dukuri të reja shkrimore si dhe të shpjerë lexuesin tek e "ndaluar" e së shkuarës. Shkrimi kritik e kërkon statusin e tekstit letrar duke e shpallur hapur e vetëdijshëm subjektivitetin si kundërvënie me kritikën të pretenduar objektive të realizmit socialist. Përmes ironisë dhe dekonstruksionit, kjo prirje kritike e përfaqësuar nga autorë të rinj të brezit të modernes së viteve '90-2000, finalizon një procedim të dyfishtë: si në status të tekstit kritik, ashtu dhe në atë letrar.

Shfaqja e medimeve të reja, sidomos pas viteve 2000 e modifikon realitetin e komunikimit, duke modifikuar edhe "shkrimin" kritik. Përshtatja me teknologjitë e mediumet e reja e bën marrëdhënien me lexuesin më të drejtpërdrejtë, më komerciale, dhe ligjërimin e saj më të reduktuar e të orientuar drejt tregut të librit. Ajo bëhet më krijuese në formulime, shumë më pak teorike, humbet metodë e terminologji, por duke u bërë më joshëse e riformulon ligjërimin e vet drejt retorikës epeditike.

\*\*\*

Duke marrë në shqyrtim përthyerjen e letërsisë në fokusin e kritikës në gazetën "Drita", si njëra prej gazetave më të rëndësishme të komunikimit kritik masiv gjatë realizmit socialist në Shqipëri, ky projekt ndjek zhvillimet, prirjet e letërsisë së kohës, kufizimet dhe, sidomos, orientimet me bazë ideologjike që i mvisheshin letërsisë.

### 3. Parametrat e studimit (metodologjia)

Në këtë zbërthim faktesh është e nevojshme si qasje e parë, ajo teorike. Kjo përqafon tri drejtimet e studimit të letërsisë: historinë, teorinë dhe kritikën, për t'iu përgjigjur pyetjeve se, çfarë ndodh me letërsinë dhe sa ndikohet ajo në produktivitetin e saj nga ngjarjet e mëdha orientuese të lëvizjeve ndër vite (kongreset, plenumet, mbledhjet e Lidhjes së Shkrimtarëve etj.). Sa dhe si analizonte dhe vlerësonte kritika, apo cilat ishin orientimet e saj? Po masat ndaj devijimeve? Gjetjet e rastit ngrenë për diskutim probleme estetike dhe metodologjike mbi të cilat krijoheshin artikujt kritikë të kohës, ndaj nevojitet edhe një qasje krahasuese mes këtyre shkrimeve.

Qasja e dytë është ajo analitike dhe kahasuere e orientuar mes ekuilibrit fakt-interpretim. Këtu merret në konsideratë dhe metoda statistikore për të identifikuar lëvizjet, të shprehura në të dhëna konkrete sipas informacioneve dhe listave bibliografike të vjela sipas qëllimit nga ky periodik. Pra, shpjegimi i punës me shifra konkrete: sa artikuj kritikë dilnin çdo vit në numrat e kësaj gazete; si ndaheshin ata në raport me letërsinë shqipe dhe atë botërore; si qëndronin në raport me llojet e krijimit sipas zhanreve; cilët ishin kritikët e periudhës etj., të gjitha këto, bëhen objekt i kërkimit statistikor dhe analitik për të ilustruar dominantet dhe prirjet.

Në këtë udhëtim historiko-analitiko-krahasues të kritikës së botuar në faqet e gazetës "Drita" gjatë periudhës 1961-1990, janë marrë në konsideratë rreth 3217 artikuj gjithsej, 2908 artikuj kritikë, pjesë e fragmente letrare për letërsinë shqipe dhe 319 artikuj kritikë, pjesë e fragmente letrare kushtuar letërsisë botërore. Në bazë të ndarjeve tematike dhe specifike janë bërë përgjithësimet e rastit. Për disa nga periudhat më të rëndësishme, që lidhen me lëvizjet në mendimin kritik, sidomos novatorizmi, janë përzgjedhur për çdo vit artikujt që kanë në fokus letërsinë, si dhe vetë pjesët letrare në poezi dhe prozë. Artikujt kritikë të përzgjedhur, të cilët janë veçuar sipas gjykimit nga artikujt e tjerë që kanë natyrë të papërcaktuar, apo që janë të natyrës së reportazhit, reflektohen në fund të studimit, duke plotësuar pjesën e dytë të tij, me bibliografinë e artikujve të përzgjedhur. Në thelb kjo është një bibliografi tematike, e para në llojin e saj, si përlligje ndaj të gjitha dukurive të vëzhguara dhe analizuara në këtë punim. Kuptohet se, nga vlerësimi dhe përzgjedhja e artikujve mund edhe të ketë një marzh të vogël gabimi në lëvizjet numerike, të cilin punimet e ardhshme në këtë fushë mund ta saktësojnë.

Ky projekt realizoi objektivat:

- ✓ Zbërthimin e fakteve të përkthyer në shifra, të dhëna konkrete mbi letërsinë (si u krijua dhe u zhvillua ajo), dhe kritikën mbi të (si u perceptua ajo), në faqet e gazetës "Drita". Pritshmëria ishte që të analizoheshin gjetjet dhe të zërthehej aktiviteti letrar i kohës në shifra lidhur me kategorizime sipas rasteve.
- ✓ Ekspozimin e studimit mbi trashëgiminë e gazetës "Drita" në një prezantim multimedial. Pritshmëria ishte që të mundësohej evidentimi për herë të parë dhe në mënyrë të plotë, i pajisur me analizë dhe metodë shkencore i situatës reale sesi vlerësohej letërsia në periudhën e mbuluar, gjë që përcaktonte dhe ndikonte prirjet e përgjithshme të kulturës së kohës.
- ✓ Raportimin e karakterit narrativ dhe dokumentar, të ilustruar me tabela, grafikë dhe foto të të gjitha dukurive që ndodhnin me letërsinë, apo artet e tjera, në lëvizjen e vlerësimit "shtetëror".
- ✓ Paraqitjen e një produkti artistik, të një "përthyerjeje" me karakter artistik dhe dokumentar në lidhje me letërsinë dhe filmin, në një *qasje multimediale*.

## 4. Shqyrtimi i literaturës

### 4.1 Periodikët, rëndësia e tyre

Revistat dhe gazetat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacionit. Ato janë përdorur për të ndikuar në opinion dhe për të përcjellë mesazhe të natyrave të ndryshme tek audienca. Për shkak të lehtësisë së shpërndarjes dhe kapacitetit të tyre për të mbuluar tema të ndryshme, periodikët kanë qenë një mjet efektiv për komunikim dhe informim masiv. Si botime periodike, në gjuhën shqipe u referohemi dy llojeve: gazeta dhe revista, të konceptuara si botime në shumë kopje me periodicitet të caktuar: ditore, javore etj., botime që kanë në përmbajtje shkrime për një ose disa fusha të ndryshme të jetës politike, ekonomike, shoqërore e kulturore, si dhe lajme për ngjarjet më të rëndësishme. Në kulturën perëndimore botimet periodike variojnë mes këtyre kuptimeve, por dallohen në varësi të qëllimit të tyre specifik. Periodikët karakterizohen nga frekuenca e botimit, e cila mund të jetë ditore, javore, një apo disa mujore, vjetore etj. Secila syresh ka një fokus të caktuar, por mund të jenë edhe gjeneraliste. Në përgjithësi, artikujt e botimeve periodike të tipit gazetë fokusohen në ngjarje aktuale dhe mundohen të sigurojnë informacion të përditësuar, ndërsa ato të tipit *journal* - e përshtashme edhe si revistë në kulturën tonë, kontribuojnë me artikuj të një ligjërimi profesional, akademik, me të cilin paraqesin kërkime, recensione, kritika, apo parashirojnë teorizime. Autorët identifikohen me punime dhe kërkime origjinale. Nga ana tjetër, gazetat prodhojnë lajmin ose informacionin edhe tematik, por sigurisht artikujt në to nuk janë të barazvlerëshëm me ata të artikujve të tipit *journal*- apo revistë shkencore. Çdo gjë është e mundur të mbulohet në botimin e të përditshmeve: nga politika te shkenca, arti dhe muzika. Zakonisht, në brendësi të tyre nuk listohen autorët, por editorialistët me kryeshkrimin e ditës. Megjithatë, në rubrikën krijuese identifikohen ata që shkruajnë letërsi.

Me ndërhyrjen dhe zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, informacioni tradicional tanimë ka kaluar në mjedisin digjital. Në këtë mjedis qarkullimi i informacionit, sidomos i lidhur me konceptin kohë është shumë më intensiv dhe i shpejtë sesa në atë tradicional. Gazetat dhe revistat sot janë më së shumti të aksesueshme online, si ato të natyrës së përgjithshme informative, ashtu edhe ato të profilizuara, që i kushtohen artit dhe letërsisë, në veçanti. Kjo mënyrë komunikimi, sigurisht,

lidhet me disa faktorë, ndër të tjera, dhe me lehtësirat që krijojnë vetë teknologjia.

Në historinë e kulturës sonë, periodikët, si ata me natyrë të përgjithshme informuese, edhe ata me natyrë të profilizuar, kanë luajtur rol të rëndësishëm. Te ne, kultura e botimeve periodike ka patur një funksionalitet konstant, që pas nismave të para të botimit për nevoja patriotike dhe kombëtare, deri te mbështetja gjuhësore, letrare dhe kulturore. Në vështrim diakronik, ndeshemi me periodikë të botuar në gjuhën shqipe dhe në ndonjë gjuhë tjetër, që i kushtohen Shqipërisë, kulturës e letërsisë së saj, qysh më 1848 ("L'Albanese d'Italia", botuar në Napoli në italisht, por me pjesë dhe në arbërisht, nga Jeronim De Rada). Edhe pse të botuar jashtë vendit, gjatë periudhës 1848-1945 morën jetë disa periodikë shqiptarë, të cilët mbajtën gjallë shpirtin dhe frymën e kombit. Vetëm sa për të përmendur disa syresh, sepse nuk është qëllimi për të sjellë këtu historikun e shtypit shqiptar, kujtojmë: "Fiamuri Arbërit" (1883-1887, Maki, Kozencë); "Albania" (1897-1909, Bruksel, Londër); "Drita" (1901-1909, Sofje); "Diturija" (1909-1929, Selanik, Bukuresht, Tiranë); "Dielli" (1909-, Boston) etj. Periodikët e kësaj periudhe shtohen në numër pas shpalljes së Pavarësisë dhe botimet bëhen kryesisht brenda Shqipërisë<sup>1</sup>, në qytetet: Tiranë, Shkodër, Korçë etj. Ata janë të natyrës gjithpërfshirëse, ashtu sikurse ka edhe revista që u kushtohen arteve dhe kulturës, si dhe letërsisë, në veçanti. Lidhur me aspektin kritik të periodikët kushtuar artit dhe letërsisë, kritika e kësaj faze njihet për debatin e saj konstruktiv, original dhe dinamik<sup>2</sup>.

Faza e dytë domethënëse, pas viteve '45 deri në 1990-ën, e njohur ndryshe si faza gjatë regjimit komunist, frymëzoi një tjetër kulturë dhe po aq një tjetër përthyerje shkrimesh nëpër periodikë. Kjo periudhë njihet edhe si pasqyruese e paradigmës së kritikës ideologjike. Tashmë qendra e botimeve në vend është Tirana. Periodikët më të shquar të kësaj periudhe janë: "Bota e re" (1945-1947); "Literatura jonë" (1947-1949); "Nëndori" (1954-1992); "Drita" (1961-1995); "Zëri i popullit" (1945-..), si dhe edukativja "Zëri i Rinisë" (1945-1993, 1995)<sup>3</sup> etj.

Ndërsa faza e tretë e botimeve periodike në Shqipëri përkon me pasvitet '90-të. Këtu, numri i periodikëve shtohet, mbulimi i tyre tematik dhe profilizimi i tyre po aq. Shfaqen edhe periodikët online, të cilët reduktojnë në masë të madhe botimet tradicionale. Duke kapërcyer rëndësinë e komunikimit dhe të frymës kritike të identifikuar në periudhat e mësipërme në botimet periodike, përpara se të identifikojmë llojet e kritikës për rastin tonë studimor, duhet që të ndalemi shkurtimisht edhe në disa tipare të kritikës letrare dhe të llojeve të saj.

1 Rugova, Ibrahim. *Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, "Faik Konica", Prishtinë, 2005, fq.117

2 Kërbizi, M., Macaj, E. "Albanian Literature in Its Critical Evaluation Process., case study: Periodicals". *Interlitteraria*, 2020. 25/2: 348-358. Tartu: Tartu University and the Estonian Association of Comparative Literature, f. 351.

3 Po aty, f.353

Në të tria fazat kritika letrare pasurohet me kuptime kontekstuale, me kompetencat e kritikut dhe llojet e kritikave po ashtu. *Shpesh kritika është parakuptuar si gjykim dhe kritiku ka marrë atributin e një eksperti që merr përsipër të flasë mbi një veprë letrare, duke ekzaminuar arritjet dhe dobësitë e veprës dhe duke artikuluar një mendim tijn rreth saj. Kjo pjesë i shton atij rolin e ndërmjetësit mes autorit, veprës dhe lexuesit; të ndërmjetësorj komunikimin mes veprës e lexuesit. Kështu, kritiku mori shpejt rolin e vlerësuesit, të inkurajimit të autorëve dhe të rekomandimit për leximin.*<sup>4</sup> Ky konstatim lidhet ngushtësisht me konceptin e kritikës dhe të kritikut ndaj veprave letrare sot, pasi që nga pretendimi i kritikës si një lloj i ri krijimi, lexuesi u familjarizua me tri kategoritë kryesore të kritikëve<sup>5</sup>: Recensionuesit/"kolumnistët" (shkrues në periodikë), kritikët "praktikë" (me shkrime të shpejta mbi veprat e autorëve), dhe shkrimtarë-kritikë (që shkruajnë prej përvojës e shijes). Koncepti i organicitetit harmonik<sup>6</sup> mes: dijes, shijes, ekspertizës, erudicionit dhe aftësisë së kritikut për artikulum ndërton sot profilin e kritikut që përballet me tekstin letrar ardhur nga kanale të ndryshme, me të cilat do të duhet të ketë përshtatshmëri. Kritiku shihet si një mediator, ndërlihdhës, komunikues mes letërsisë (në çdo format qoftë ajo) dhe pjesës tjetër (qoftë me autorin, lexuesin, kulturën etj). Kritika e kohës së regjimit manifestoi natyrisht kritikën e shkruar në periodikë, atë të zhvilluar në artikuj studimorë, monografi, e në aktivitete shkencore, por në të gjitha rastet ajo pati të njëjtin instrument matës - ideologjinë.

Për të rrokur në mënyrë sa më të plotë dukuritë që karakterizojnë shkrimet kritike, por edhe vetë statusin e kritikës të kristalizuar në 30 vitet e gazetës "Drita", organ i rëndësishëm i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, bëhet e nevojshme të hidhet fillimisht dritë mbi zhvillimet e letërsisë së realizmit-socialist në Shqipëri.

## 4.2 Letërsia e realizmit socialist

Letërsia shqipe gjatë periudhës së diktaturës e sjell *tekstin letrar si autoritet e autorialitet shtetëror*. Të kuptuara si instrumente të vlefshme në shërbim të propagandës shtetërore e partiake (që bëhen e njëjta gjë), letërsia dhe artet përkufizohen si "ndihmëse të partisë". Vetë letërsia u bë produkt i marrëdhënies letërsi-pushtet. Ndonëse e importuar, praktika e vërtetë e realizmit-socialist shqiptar është rezultat i diktatit të institucioneve politike të diktaturës, të cilat, në një koherencë të skajshme mes tyre e me një vullnet thellësisht politik përtej letërsisë, e nënshtrojnë atë me rrjetin e tyre kapilar. Një varg institucioneve shtetërore performative për/mbi letërsinë e dobësojnë deri në themel atë si institucion autonom, status të cilin letërsia shqipe e

4 Macaj, Edlira. *Letërsi-Ab initio*. Tiranë: Albas, 2019, f.108

5 Quinn, Edward. *A Dictionary of Literary and Thematic Terms*. Bot. 2-të. New York: Facts on file, 2006, f.101

6 Mendelsohn, Daniel. *A critic's Manifesto*, 2012. Aksesuar nga: <https://www.newyorker.com/books/page-turner/a-critics-manifesto> Mendelsohn është eseist, kritik, profesor i humaniteteve.

kishte mbërritur tashmë gjatë modernitetit letrar të gjysmës së parë të shekullit XX. Nga udhëzimet e urdhëresat e Komitetit Qendror, te plenumet e kongreset e Partisë, te plenumet e kongreset e Lidhjes, te mbledhjet e diskutimet e kolektivave punonjëse, rrjedh formatimi i panegociushëm i shkrimit të letërsisë në formula ideologjike, të shndërruara përdhunshëm në tema, karaktere e figura, duke e reduktuar letërsinë shqipe në një ushtruese të përunjur të detyrës shtetërore që i është imponuar: ndihmëse e partisë në edukimin revolucionar të masave të mobilizuara në ndërtimin e socializmit. Ky nënshtrim realizohet përmes një procesi të shtrirë për gati gjysmë shekulli, duke zënë fill me vendosjen e diktaturës komuniste më 1945 dhe mbyllet me rënien e sistemit totalitar më 1990. Letërsinë shqipe në marrëdhënie me pushtetin do ta karakterizojnë dukuri të tilla si:

- **Përdorimi i letërsisë kryesisht si propagandë** përmes *direktivash metodike e modeluese*, si: partishmëria komuniste, botëkuptimi marksist-leninist dhe militantizmi, perspektiva historike dhe optimizmi historik, heroi pozitiv, përmbajtja socialiste dhe forma kombëtare;
- **Pasqyrimi i luftës së klasave**, karakteri popullor, lufta kundër ndikimeve të huaja, lufta kundër konservatorizmit dhe liberalizmit;<sup>7</sup>
- **Kriza e reales në shkrimin letrar**, që buron prej kërkesës këmbëngulëse për pasqyrim objektiv të një iluzioni të reales që duhej shpikur e paketuar detyrimisht nga letërsia si realitet faktik e më pas frymëzues për masat. Në të vërtetë letërsia shqipe e realizmit socialist pasqyron një realitet institucional partiak;
- **Imponimi i karakterit militant dhe i frymës luftarake** si rezultat i kërkesës për të pasqyruar luftën e klasave, luftën për ndërtimin e socializmit, luftën kundër zakoneve prapanike e besimeve fetare, luftën për emancipimin e gruas, luftën për triumfin e të resë, LANÇ etj. "Kultura jonë e re duhet t'u shërbejë besnikërisht interesave të klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, t'u shërbejë këtyre klasave si armë e fuqishme për të ndërtuar socializmin dhe për të luftuar tërë armiqtë e klasës"<sup>8</sup> – udhëzonte në fjalën për 10-vjetorin e Çlirimit më 1954 Enver Hoxha;
- **Reflektimi i agjendës së politikës së jashtme të PPSH**, ku spikat shfaqja në letërsinë shqipe e figurës së udhëheqësit politik e ideologjik të fuqisë së huaj në të cilën mbështetet shteti komunist shqiptar në periudha të ndryshme, si për shembull, Lenini e Stalini, Mao etj., por edhe tematika e miqësisë mes popullit shqiptar e atij jugosllav, rus e sovjetik, kinez, vietnamez etj., dhe tematika e bllokadës imperialisto-revizioniste;

<sup>7</sup> *Historia e letërsisë së realizmit socialist*, pjesa I dhe II, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1985/1986

<sup>8</sup> Hoxha, Enver. *Veptra XII*, Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1972, f.164

- **Zhvillimi tematik i letërsisë sipas direktivave detyruese të pushtetit**, në tematika të përhershme, si: LANÇ, e kaluara në rendin "çifligaro-borgjez", jeta e re socialiste, puna në kantiere e vepra, historia kombëtare, emancipimi i plotë gruas, figura e partisë dhe e udhëheqësit suprem, të cilat shndërrohen në simbole të së vërtetës absolute (pishtar ndriçues), të afektit mëmësor e atësor (nëna Parti) dhe të nxitjes për veprim revolucionar etj. Por kemi edhe tema që shfaqen në fushata politike, si: lufta kundër burokratizmit, kundër revizionizmit, kolektivizimi dhe jeta e fshatit.

*Këto tematika të përqendruara mbi kolektiven, nuk lejojnë zhvillimin e natyrshëm të individuale përmes temave të intimes, erotikes, vdekjes. Mbetet i vështirë e thuajse i pamundur në letërsinë e realizmit socialist shkrimi i intimes e cila shfaqet përgjithësisht si pohim i vullnetit kolektiv, shkrimi i krizës ekzistenciale të vdekjes e cila vjen vetëm si heroike ose "e merituar" për armikun e popullit, shkrimi i seksualitetit i cili asgjësohet krejtësisht, ndërsa erosi dhe erotikja mpaket në klishe moralizuese. Ky reduktim i mbivendoset edhe temës së emancipimit të gruas, duke e zhveshur figurën femërore nga erotikja, feminiteti, delikatesa dhe elementet e intimes e karnales dhe duke i veshur role sociale, tipare burrërore e sjellje luftarake.*

Zhvillimi zhanror i letërsisë sipas direktivave të pushtetit duke ndikuar modelimin gjinor të letërsisë në zhanre me potencial narrativ që i përshtaten më mirë qëllimeve të propagandës, si për shembull: lëvrimi i poemës epike dhe baladës përshtatur me tematikën e heroizmit revolucionar; lëvrimi i romanit përshtatur me tablonë e gjerë të zhvillimit socialist të vendit, por edhe të LANÇ-it; lëvrimi i dramës përshtatur me direktivën e antagonizmit klasor, të brezave, të mendësive etj; satirikja si zgjatim i agjendës politike të ditës etj.

Ndërsa në nivel të procedeve letrare, në lirikë kolektivizohet uni lirik, epikja heroizohet deri në pllakatizëm; në prozë mbizotëron narratori i gjithëdijshëm që ndërton e tregon një botë sipas vetëdijes socialiste uniforme e kompakte, bëhet mbizotëruese antitetikja në nivel të personazhit e ndërtimit të fabulës, duke e zgjidhur konfliktin sipas modelit dramatik; ndërkohë që vetë drama shndërrohet në mise en scene të iluzionit institucional të reales.

Kritika letrare dhe metaligjërimi i saj janë në koherencë të plotë me ligjërimin e partisë –shtet si vijuese e amplifikuese të udhëzimeve, urdhëresave dhe vendimeve politike e administrative. Janë këto të fundit që përmes shkrimit kritik shndërrohen në modeluese të një manifesti të ri letrar në Shqipëri, një realizëm socialist sui generis, i cili përditëson vetveten sipas një agjende politike (e ashtuquajtura çështja e pasurimit të pandërprerë të realizmit socialist krahas zhvillimit të shoqërisë<sup>9</sup>).

<sup>9</sup> *Historia e letërsisë së realizmit socialist*, pjesa I, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1985 f. 8

Dukuritë e mësipërme që karakterizojnë letërsinë shqipe të realizmit socialist janë pasoja të drejtpërdrejta të diktatit partiak mbi letërsinë përgjatë 45 viteve. Ato mund të hetohen në koherencë me zhvillimet politike e të shqyrtohen në disa faza, ku secila prej tyre përmban momente kyçe të represionit modelues të institucioneve politike ndaj letërsisë. Këto faza janë:

**Faza 1 (1945-1949):** nga fillesat e ideologjizimit marksist-leninist te nënshtrimi institucional i letërsisë; **Faza 2 (1950-1960):** nga nënshtrimi te djerrina e letërsisë propagandistike; **Faza 3 (1961-1990):** nga modelimi te implementimi i një realizimi socialist shqiptar në dukje sui generis. Le të fokusohemi te kjo e fundit, lidhur me objektin tonë konkret studimor.

Në Shqipëri letërsia ishte e ndikuar thellësisht nga vendimet, urdhrat, urdhëresat politike, të cilat zbërtheheshin në diskutimet që bëheshin në Lidhjen e Shkrimtarëve,<sup>10</sup> por edhe në institucionet botuese dhe kritike, nga të cilat shkrimtari mund të shkëlqente, por edhe të fundosej. Kjo praktikë ishte në sinkroni me ideologjinë shtetërore, sipas së cilës personaliteti njerëzor varej nga shoqëria dhe se asgjë nuk ishte jashtë saj dhe e pavarur. Nga ana tjetër, prania e partisë është domosdoshmëri edhe në arte. Ajo ka ndikim te të gjitha veprimtaritë intelektuale, ose thjesht nënkupton nënshtrimin e tyre në interes të saj e të udhëheqësit.

Kur Althusser rimori konceptin e ideologjisë, për t'i gjetur asaj identitetin (e "interpelancës ideologjike"), ai analizoi marrëdhëniet e nevojshme midis shtetit dhe subjektit (individit). Ai përfshiu jo vetëm një analizë të shtetit dhe sistemeve të tij ligjore dhe arsimore, por edhe të marrëdhënies psikologjike që ekziston ndërmjet subjektit dhe shtetit si ideologji. Për Althusser-in ideologjia nuk ekziston te "bota e ideve", e konceptuar si "bota shpirtërore", por në institucione dhe praktika specifike të tyre. Po sipas tij, regjimet ose shtetet janë në gjendje ta mbajnë kontrollin duke riprodhuar subjekte-individë që besojnë se pozicioni i tyre brenda strukturës shoqërore është i natyrshëm me funksionet e mësipërme. Këtë rol e luajnë mirë edhe kritikët. Pyetja kërkuese, në këtë rast, është: *cilat janë ndërhyrjet konkrete ideologjike që ndikojnë në receptimin e letërsisë, konkretisht në rastin tonë të studimit?*

### **4.3 Nga modelimi te implementimi i një realizmi socialist shqiptar në dukje sui generis**

Periudha midis viteve 1961-1990 në Shqipëri karakterizohet nga vullneti politik për të zhvilluar një letërsi të realizmit socialist *sui generis*. Të mbetur pa një model bashkëkohës si ai i realizmit socialist sovjetik, tashmë i tejkaluar në vendin e origjinës, kërkohet "rishpikja" e metodës. Kjo rishpikje synohet për qëllime të

<sup>10</sup> Viti 1945 - themelimi i Lidhjes me 70 anëtarë; qershor 1946 konferenca e II; viti 1949 konferenca III, etj.

ndryshme nga dy skajet e marrëdhënies pushtet-letërsi. Vullneti institucional partiak përmes direktivave, dhe ata shkrimtarë që nënshtrohen me zell përpigën të krijojnë realizmin socialist "të vërtetë", pasqyrim i një socializmi "të vërtetë" të cilit shteti komunist shqiptar i del zot ndërsa kampi i Lindjes po e braktis hap pas hapi. Në skajin tjetër, një grup i vogël shkrimtarësh të rinj, në fillimet e kësaj faze, e kapërcejnë skematizmin dhe shterpësinë e prodhimit letrar të realizmit socialist të fazave të para, përmes rimodelimit të tij në procedë letrare, në kërkime formale, në ligjërim të figurshëm etj., pa e "tradhtuar" as qëllimshmërinë e as funksionin e kësaj letërsie. Më pas, ky rimodelim bëhet letërsia e realizmit socialist në dukje *sui generis*, por e mbështetur në zhvillimet e letërsisë sovjetike të realizmit socialist, estetikisht më e suksesshme e funksionalisht më efikase për synimet e pushtetit.

Edhe prodhimi letrar do të zhvillohet në dy pamje: njëra, dominante për nga sasia, por mediokre për nga cilësia, i gjegjet pikë për pikë skemës që prodhon *sui generis* pushteti, por që përsëri mbetet, ashtu siç është, e padobishme për propagandën e pushtetit; tjetra, më cilësore në shkrim, me një potencial të lartë leximi, pikërisht falë talentit e letrarësisë e tejkalon propagandën, herë duke e maskuar, e herë duke e mashtruar. Është kjo lloj letërsie mbi të cilën do të mbështetet propaganda e pushtetit për të shpallur suksesin e letërsisë së realizmit socialist, sidomos jashtë vendit. Në këtë rrugëtim të realizmit socialist gjatë viteve 1961-1990, të lidhur ngushtë me momentet më të ashpra të represionit, krijimtaria e një autori mund të shfaqet në të dyja pamjet, me vepra shumë të ndryshme nga njëra-tjetra.

Letërsia shqipe e realizmit socialist në këtë fazë shprehet në të tria gjinitë, duke krijuar për herë të parë një pamje të plotë të prozës së gjatë.

Romani, gjinia e kërkuar me çdo kusht prej pushtetit si narrativë e realitetit utopik, e ndërton më në fund një botë me temat e kërkua prej direktivave, me personazhet që e gjallojnë sipas skemës, me kontradiktat antagonistë e joantagoniste, me optimizmin ideologjik dhe me sfondin e ndërtimit të socializmit, historisë kombëtare apo LANÇ-it. Me një kompozicion më të qëndrueshëm e procedë letrare më të larmishme në veprat më të mira, proza e gjatë bëhet gjinia më e rëndësishme për të gjithë, si për lexuesin ashtu dhe për institucionet e pushtetit. Këto vepra, të shkruara nga autorë të rinj e të talentuar, të formuar në kampin e Lindjes, pikërisht kur ai po e tejkalonte realizmin socialist ortodoks dhe po i njihte letërsisë e artit të drejtën e shprehjes individuale dhe hapjen ndaj modeleve perëndimore, krijuan fondin e romanit në vend.

Poezia, krahas trajtave epike e baladeske që i vijon nga fazat e mëparshme, bashkë me pllakatizmin e pandërprerë, zhvillon edhe një lirikë më pak kolektive e një figuracion të fortë metaforik, por pa iu afruar thellësisë së poezisë meditative, metafizike etj.

Dramaturgjia, megjithëse mbetet thelbësisht propaganduese, një *mise en scene*

e iluzionit institucional të reales, fiton pjekuri në teknikat dramatike të dialogut, monologut e të zhvillimit të konfliktit dramatik.

Kritika letrare, përkundrazi, nga një zhanër që nis të shkruhet nga vetë shkrimtarët shndërrohet, sidomos pas viteve '70-të, në një akt censure e deri një akt-ekspertize i kryer prej Sigurimit të Shtetit, i cili tashmë merr edhe funksionin (jo publik) të kritikës. Gjithashtu, një nga tiparet që fiton realizmi socialist në dukje *sui generis* në këtë fazë është procesi i autocensurës, i cili vigjilon mbi shkrimin e letërsisë dhe bëhet tipar dominant i saj.

Në fillim të viteve '60-të novatorizmi, edhe ai i importuar prej lëvizjeve letrare e jashtëletrare të zhvilluara në ish-Bashkimin Sovjetik, shenjon një përplasje brezash letrarë e poetikash, e cila përfundon politikisht në një bashkëjetesë të detyruar brenda termit, derisa të "rinjtë" hyjnë në qendër të sistemit letrar. Ndërsa në fillim të viteve '70-të, kritika zyrtare e përdor termin *novatorizëm* në një kuptim thuajse të kundërt, si radikalizim konservativ e antiliberal të realizmit socialist. Në fillim të viteve '80-të *novatorizmi* konvertohet në direktivën për një letërsi thellësisht militante. Në thelb, *novatorizmi* përdoret si flamur beteje për realizmin socialist në dukje *sui generis* nga të dyja skajet e marrëdhënies pushtet-letërsi.

Thelbi i novatorizmit të debatuar e të sprovuar me sukses nga poetët e rinj, qëndron në një kapërcim estetik të letërsisë së realizmit socialist më dogmatik, duke u konvertuar në një realizëm socialist në dukje *sui generis*. Duke ndjekur këtë ndryshim, edhe një pjesë e vogël e kritikës deri në fillim të viteve '70-të, tenton disa nuancime të parimeve bazë të realizmit socialist si: "pasqyrimi i realitetit" konvertohet në "pasqyrim figurativ të realitetit", deri në "riprodhim të realitetit"<sup>11</sup>, "transfigurim subjektiv"<sup>12</sup> të tij; ndërsa "konflikti i luftës së klasave" konvertohet drejt një termi më neutral, si "kontradikta të jetës"<sup>13</sup> etj.

Letërsia shqipe e realizmit socialist, tashmë, përmes krijimtarisë së shkrimtarëve të rinj të shkolluar në Lindje, të ushqyer nga një "revizionim" i realizmit socialist, por edhe nga e ashtuquajtura "letërsi dekadente" që përkthehej e botohej në vendet e kampit Lindor, po hynte më në fund në një fazë të re, ku do të merrte më shumë përparësi vlera artistike e forca estetike e tekstit letrar. Këto cilësi të reja do të siguronin pëlqyeshmërinë dhe suksesin publik të veprës e si të tilla do të bëheshin shumë më të efektshme politikisht për të përcjellë ideologjinë e propagandën, qëllimshmëri parësore këto të realizmit socialist. Por, teksa bëheshin më të pëlqyeshme e më të efektshme, këto vepra shfaqeshin në sytë e pushtetit edhe si më të rrezikshme, pikërisht për shkak të ndikimit që mund të ushtrojë një vepër artistike mbi publikun dhe pamundësisë për të kontrolluar deri në fund potencialet e saj të leximit. Për

11 Uçi, Alfred. *Estetika dhe jeta*, cituar sipas Ibrahim Rugova, *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Eurorilindja, Tiranë, 1996, f.219

12 Zheji, Gjergj. *Artisti dhe jeta*, cituar sipas Ibrahim Rugova, po aty, f.219

13 Bullo, Jorgo. "Asnjë recetë", cituar sipas Ibrahim Rugova, po aty, f.245

rrjedhojë, do të jenë pikërisht këto vepra që do të dënohen më shumë, në fushata të herëpashershme ndëshkuese, ku u hamendësohet një lexim "devijues" nga ideologjia, ndonëse veprat në përgjithësi as e kanë dhe autorët e tyre përgjithësisht as e synojnë një "devijim" të tillë.

Që në fillim të viteve '60-të, kornizuar në data plenumesh, kongresesh, mbledhesh e fjalimesh<sup>14</sup>, do të duken shenjat e forta të leximit vigjilent partiak dhe shenjat edhe më të forta të represionit mbi vepra e shkrimtarë.

Një datë domethënëse e represionit mbi letërsinë e artet është sidomos Plenumi IV i vitit 1973, ku institucioni partiak, i gjendur përballë një krijimtari artistike me frymëmarrje më të çlirët (ndoshta toleruar nga një pjesë e vetë sistemit) dhe të përçafuar nga jo pak artistë të fushave të ndryshme, reagon fuqishëm e me të gjithë arsenalin, duke rivënë në punë strukturën piramidale të kontrollit kapilar e të ndëshkimit. Ndonëse kjo frymë u ndje më tepër në artet e skenës e artet figurative, vala e goditjes do të përfshijë edhe letërsinë e cila ishte treguar sidoqoftë më e kursyer në shmangien e hapur të direktivave. Por krijimtaria letrare do të akuzohet për shtrembërim të realitetit, liberalizëm, ndikime të huaja, dobësim të luftës së klasave, përqendrim në tema të vogla e më intime, përparësi të formës ndaj përmbajtjes si qëllim i vetëm i kërkimit artistik, mjegullim të kuptimit deri në hermetizëm etj.<sup>15</sup>

14 Veçanërisht: Plenumi XV i KQ të PPSH-së mbajtur më 25-26 tetor 1965; qarkullimi i shkrimtarëve për njohjen e jetës, janar 1966; Kongresi V i PPSH-së; Plenumi i Komitetit të Partisë së Tiranës më 1968; Konferenca 17 e Partisë për Tiranën më 21 dhjetor 1968; Kongresi VI PPSH-së; Diskutimi i Enver Hoxhës në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor më 9 janar 1973; Mbledhje e Komisionit të Kulturës dhe diskutimet me shefat e redaksive, redaktorëve të shtëpive botuese më 16 prill 1973; Mbledhje dhe diskutime me krijues në periudhën janar – maj 1973 nisur nga fjalimet e E. Hoxhës: ndikimet e huaja në poezi, ndikimet e huaja në dramaturgjë, ndikimet e huaja në tregime e novela, ndikimet e huaja në letërsinë për fëmijë, vendime mbi lejen krijuese dhe qarkullimin e artistëve; Plenumi IV i KQ të PPSH-së më 26-28 qershor 1973; Aktivi i Partisë Tiranë për problemet e letërsisë dhe artit më 14 nëntor 1973; Orientime të KQ dhe Këshillit të Ministrave për forcimin e kontrollit paraprak të krijimtarisë artistike në dhjetor 1973; Raport i E. Hoxhës mbi detyrat e lëna nga Plenumi IV më 22 dhjetor 1974; Kushtetuta e RPSH më 28 dhjetor 1976; Plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve 18 mars -19 mars 1982, Diskutimet në Lidhjen e Shkrimtarëve mbi "Gjakftohtësinë" e I. Kadaresë më 1983, Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit i vitit 1984, *Indoktrimi komunist përmes kulturës letërsisë dhe arteve*, Vëll. 4, dok. 79-81.

15 "Në disa vepra të letërsisë, drama, poezi e poema, tregime e novela, e në ndonjë film etj., është shtrembëruar realiteti. Kontradiktat e ndryshme dhe lufta që zhvillojnë Partia e populli kundër fenomeneve negative, pengesave e vështirësive janë pasqyruar jo nga pozita e Partisë, por nga pozita të kundërta me to". "Në emër të "së resë", synohet të mohohet e sotmja dhe lufta midis së vjetrës dhe së resë paraqitet si luftë e pashmangshme midis brezave. Ndikimet e huaja kanë çuar deri atje sa në ndonjë tregim të errësohen madhështia e LANÇ e heroizmi partizan"; "Pasojë e ndikimeve të huaja është kapja e tepruar pas temave të vogla intime, largimi nga problemet e mëdha shoqërore, tema e vetmisë së njeriut, kur ky u shndërrua në kërmill, fik deti e absurditete të tjera, fenomene që janë të lidhura me ndikimin e filozofisë e të estetikës ekzistencialiste, si dhe të rrymave letrare, si simbolizmi etj."; "Duke luftuar për mbrojtjen e frymës kombëtare të letërsisë e të artit, ne gjithmonë theksojmë me forcë karakterin e tyre revolucionar e socialist. Brenda socialiste është tipari dallues e më esencial i letërsisë dhe i artit tonë. Kjo brendi ka një karakter të qartë klasor proletar. Si e tillë ajo duhet të realizohet në unitet me formën kombëtare, gjë që e shohim edhe në praktikën e krijimtarisë sonë letraro-kombëtare "; "Ne kemi nevojë për një kritikë shkencore e të kualifikuar, e cila ka brenda edhe patosin e domosdoshëm revolucionar, aq të nevojshëm për zbulimin e vlerave të shquara të letërsisë e të artit, edhe frymën e papajtueshme me

Akuzat partiake pasohen nga masa shtrënguese dhe pushteti do ta ndjekë zbatimin e tyre me vigjilencë. Ndër instrumentet e represionit brenda institucioneve të letërsisë shquhet roli i kritikës, me gjithë laryshinë që përmban termi, që nga kritika e botuar fshikulluese ideologjike, te kritika në kolektiv mes shkrimtarëve, kritika nga redaktorët e recensentët në shtëpi botuese, në organet e shtypit të Lidhjes së Shkrimtarëve, deri te punonjësit e sigurimit të shtetit që veshin kostumin e kritikut, recensuesit apo redaktorit. Dosjet hetimore që çuan në burgosjen e Kasëm Trebeshinës e Visar Zhitit e shumë të tjerëve dhe në vrasjen e Vilson Blloshmit, Genc Lekës e të Havzi Nelës, kanë brenda episode të kësaj kritike. Gjurmët e këtij sistemi kapilar duken qartë në orientimet për hartimin e një plani të hollësishëm nga KQ dhe Këshilli i Ministrave mbi kontrollin paraprak të krijimtarisë letrare në muajt që pasuan Plenumin IV, ku bie në sy edhe forcimi i "kontrollit punëtor" mbi botimet.<sup>16</sup>

Në këtë klimë, një moment tjetër domethënës i represionit ndaj letërsisë është Plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në mars të vitit 1982. Për arsye që lidhen kryesisht me politikën e ditës, me eliminimin e Mehmet Shehut, Lidhja do të përdoret nga pushteti për të goditur në mënyrë specifike shkrimtarin Ismail Kadare, i cili gjatë atyre ditëve është duke u marrë në pyetje në hetuesi. Vepra për të cilën linçohet, *Nëpunësi i pallatit të ëndrrave*, që ia kishte dalë të shmangte pengesat e censurës, i kishte vërtetë potencialet e forta të një leximi alegorik demaskues të tiranisë e diktaturës, por sulmi i kolegëve, kritikëve e pushtetarëve ndaj veprës e autorit zhvillohet në mënyrë të sinkronizuar<sup>17</sup>.

Në fakt, jo më pak të sinkronizuara kanë qenë këto instanca për dekada me radhë edhe në dënimin e ndalimin e veprave si: *Qyteti i fundit*; *Stina e armëve*; *Një*

---

asnjë shtrembërim, me asnjë shfaqje të huaj në zhvillimin e tyre."; "Por kritika letraro-artistike nuk është i vetmi gjykues i veprimtarisë letraro-artistike. Mendimi i lexuesve, i publikut, i gjithë opinionit shoqëror në fund të fundit është gjykatësi më i drejtë i kësaj krijimtari. Këtë të vërtetë duhet ta mbajnë kurdoherë parasysh si krijuesit dhe kritikët"; "Shumë koncepte e teorizime që u kritikuan më lart kanë gjetur strehë në veprimtarinë e Lidhjes, në organet e shtypit të saj, veçanërisht në gazetën "Drita"; "Lidhja të marrë masa serioze e me përgjegjësi për të mos lejuar më shfaqje të ideologjisë borgjeze e revizioniste në sferën e veprimtarisë së saj."; "Eksperienca na ka mësuar se këta deviatorë nuk lindin në një ditë, ata formohen, përfitojnë nga lëshimet, nga paqartësia politiko-ideologjike, nga mungesa e vigjilencës, nga rrethanat e brendshme dhe të jashtme. Këta maskohen, ruhen [...]", Enver Hoxha, *Mbi letërsinë dhe artin*, f. 375-443

16 Hartimi i planit tematik vjetor të botimeve dhe miratimi i tij nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, në konsultim me KQ dhe KM. Aprovimi për çdo vepër nga redaktori përkatës dhe shefi i redaksisë. Veprat për të cilat recensentët ose redaksia kanë shqetësime ideore i aprovon drejtori ose zëvendësdrejtori i shtëpisë botuese. Disa vepra, edhe nga drejtori e zv. drejtori. Çdo vepër, para se të redaktohet, u jepet për recension njerëzve me formim të mirë ideestetik (shkrimtarë, kritikë, si dhe punonjës të tjerë që kanë përgatitjen e nevojshme). Recensentët i cakton redaksia. Problemet diskutohen në redaksi ku mund të ftohet edhe autori. Kur ka divergjencë dhe nuk arrihet mirëkuptim, atëherë vepra shqyrtohet në mbledhjen e kolegjiut të shtëpisë botuese. Për këtë vihet në dijeni edhe Min.Ars e Kult. Edhe në shtypshkronjat ku botohet letërsia artistike ushtrohet në mënyrë sistematike kontrolli punëtor mbi të, duke gjetur format përkatëse, duke krijuar komisione apo grupe punëtorësh, të cilët, herë pas here, diskutojnë mbi vepra të ndryshme dhe bëjnë vërejtjet e tyre mbi to, gjer në shfaqjen e mendimit që të botohet apo të mos botohet vepra." *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit*, Vëll III, dok. 63

17 *Indoktrinimi...*, Vëll. IV, dok. 51, 52, 53, 54

*emër në katër rrugë; Niku i Martin Gjinit të P. Markos, Dueli; Rrugë të tërthorta; Kur Qeshte tërë qyteti të Q. Buxhelit, Rrethimi i bardhë i N. Priftit, Drama e Partizanit pa emër; Më jepni një emër; Cipa e borës të F. Arapit, Zhurma e erërave të dikurshme; Mosha e bardhë; Fytyra e dytë të D. Agollit, Shkrimtari i M. Myftiut, Një emër në mes yjeve e K. Dushit, Përbindëshi; Në mesditë byroja politike u mblodh; Nëpunësi i pallatit të ëndrrave; Nata me hënë të I. Kadaresë, Tuneli i Dh. Xhuvanit, Njollat e murrme të M. Jeros, Çështja e inxhinier Saimirit e Fadil Paçramit, Ata të dy e të tjerë, K. Kosta etj., por edhe qortohen shumë vepra të tjera e autorë (Dh. Qiriazit, F. Haliti, J. Bllaci, Xh. Spahiu, F. Rreshpja, M. Zeqo etj.)*

Në anën tjetër, ndonëse letërsia do të vijojë rrugën e kërkimeve formale e të procedeve artistike "novatore", ajo do të vazhdojë (ndonjëherë edhe *pro forma*) t'u përgjigjet direktivave të pushtetit edhe në shtyllat themelore të realizmit socialist si lufta e klasave, partishmëria proletare, optimizmi revolucionar etj., edhe në tematika të detyrueshme, të cilat shpesh lidhen me politikën e brendshme e të jashtme të ditës. Tema të tilla si lufta kundër fesë, lufta për emancipimin e plotë të gruas, lufta kundër burokratizmit, tema e heroizmit masiv, e njeriut të ri dhe e familjes së re, tema e luftës kundër zakoneve prapanike e konservatore, e luftës kundër shfaqjeve liberale e moderniste, e luftës kundër bllokadës së egër, e elektrifikimit, e rolit të komunistit dhe Partisë, e rolit të udhëheqësit etj., të gjitha të udhëzuara në direktivat e dokumenteve partiake vijojnë të korrespondojnë në kohë me botimin e veprave konkrete letrare.<sup>18</sup>

Edhe pas vdekjes së Enver Hoxhës, marrëdhënia mes pushtetit partiak e letërsisë mbetet koherente, tashmë me një retushim të dykrahshëm: pushteti hiqet si më i "paqtë" ndaj letërsisë, letërsia si më e "guximshme" për të pasqyruar këtë paqtim me pushtetin, duke poetizuar gjendje e peizazhe më individuale në një poezi gjithnjë e më lirike, duke vizatuar personazhe më pak heroikë, tema më intime në një prozë gjithnjë e më urbane. Sidoqoftë, inercia e censurës së gjatë dhe e autocensurës së ngulitur do t'i privojë shkrimtarët nga shpërthimi i kontureve të realizmit socialist në dukje *sui generis* të ndërtuar e sanksionuar tashmë në letërsinë shqipe. Madje një pjesë prej tyre nuk do të mundën të shkruajnë ndryshe edhe pas rënies së diktaturës komuniste më 1991.

Këtë vështrim panoramik që përmban dukuri të përcaktuara sipas ndikimeve politike ndër vite e shohim më poshtë konkretisht te gazeta "Drita", organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

<sup>18</sup> Si për shembull romanet *Dasma* e I. Kadaresë dhe *Përsëri në këmbë* dhe *Tuneli* të Dh. Xhuvanit, *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo* e D. Agollit, *Këngë në minierë* e Dh. Shuteriqit, *Tokë e ashpër* e T. Laços, *Poema e dritës* e Ll. Siliqit, *Përse mendohen këto male* e I. Kadaresë, *Cuca e maleve* e L. Papës, *Fisheku në pajë* i F. Krajës etj.



## 5. Gazeta “Drita” – letërsia dhe ligjërimi mbi të

### 5.1 Vitet 1961-1965


Çfarë ndodh me botimet letrare në këtë pesëvjeçar, dhe më konkretisht, duke patur në konsideratë si rast studimi specifik nisjen e pasqyrimin të tyre në gazetë që në vitin 1961? Cilat ishin tiparet e botimeve letrare dhe të kritikës letrare në gazetën “Drita”?

#### Viti 1961

“Po agon” është kryeartikulli i numrit të parë, përmes të cilit redaksia lajmëron lindjen, Dritën e Re. Viti 1961 reflekton në gazetën “Drita” vendimet, urdhëresat dhe ngjarjet politike të kohës, sidomos ato që lidhen me letërsinë dhe rrugën e saj të zhvillimit. I tillë është vendimi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve. Ky vendim tregon mbi rolin e rëndësishëm që kanë krijuesit dhe artistët në revolucionin kulturor, prandaj ata duhet të rendin drejt temave aktuale, heronjve pozitivë, në mbështetje të traditës, por edhe drejt novatorizmit të poezisë. Paralel me këto porosi, duhet të zhvillohej edhe kritika letrare. Nga ana tjetër, Plenumi i vitit 1961 përmban në thelb dy fjalime të rëndësishme të cilat do të vulosin atë që kërkohet nga letërsia dhe se si duhet të jetë ajo. Dy fjalimet e mbajtura, ai i Enver Hoxhës dhe i Ramiz Alisë, përthyhen në kërkesa dhe vlerësime që do t’i bëhen letërsisë së kohës.

**Botimet letrare:** Sipas të dhënave të marra nga gazeta “Drita”, letërsia shqipe në këtë vit përmban në zërat e saj krijimtari artistike në poezi rreth gjashtë herë më shumë se në prozë (120/29). Edhe pasqyrimi i letërsisë botërore me përkthimet e saj në gjuhën shqipe ruan po ashtu një raport epërsie të poezisë ndaj prozës (27/7), ndërsa kritika me dramatikën (tragjedinë, dramën, komedinë) nuk ka asnjë zë përfaqësues në të dyja letërsitë. Përkthimet në këtë vit sjellin në gjuhën shqipe pjesë nga letërsia mongoleze, ukrainase, kiliane, kubaneze.

Letërsi shqipe				Letërsi botërore		
1961	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama
	120	29	0	27	7	0



**Kritika letrare:** Në numrat e këtij viti, në gazetën “Drita” artikujt kritikë udhëzojnë aspekte të zhvillimit të letërsisë, prej së cilës vijon të pretendohet besnikëri “e patundur” ndaj Partisë. Kjo “besnikëri”, në thelb shenjon statusin e shkrimit kritik, i cili shtrihet edhe mbi letërsinë e traditës, edhe mbi letërsinë korrente. Traditën “e cunguar” në shkrimet kritike të këtij viti e përfaqësojnë Migjeni, Mjedja,

Serembe etj. Letërsia korrente më shumë udhëzohet se sa lexohet, duke iu përshtatur perspektivës së temës shoqërore dhe frymës së kohës në letërsi, si p.sh. në artikullin e Kin Dushit “Disa fjalë rreth temës shoqërore në letërsi”; në artikullin e Dalan Shaplllos “Pasqyrimi i tipareve të kohës” si dhe në artikullin e Agim Shehut “Fryma e kohës në poezinë tonë”. Nga ana tjetër, pasqyrohet kërkesa për të patur në letërsi lëvrimin e temës shoqërore<sup>1</sup>. Dominon prirja për ta parë letërsinë në dikotominë traditë/novatorizëm, siç duket në artikujt: “Traditë dhe novatorizëm”<sup>2</sup> të Mark Gurakuqit; “Traditë, natyrisht, por jo shtampë”<sup>3</sup> të Dritëro Agollit etj.



1 Dushi, Kin. “Disa fjalë rreth temës shoqërore në letërsi”, *Drita*, nr.22, f.2, 1961; Shaplllo, Dalan. “Pasqyrimi i tipareve të kohës”, *Drita*, nr.24, f.2, 1961; Shehu, Agim. “Fryma e kohës në poezinë tonë”, *Drita*, nr.12, f.2, 1961  
 2 Gurakuqi, Mark. “Traditë dhe novatorizëm”, *Drita*, nr.32, f.1,1961  
 3 Agolli, Dritëro. “Traditë, natyrisht, por jo shtampë”, *Drita* nr.35, f.1, 1961

Në kritikën e këtij viti artikujt më të rëndësishëm lidhen me *orientimin ideologjik të artit në përgjithësi*, si ai i Leninit për artin<sup>4</sup> dhe të orientimeve konkrete që dalin prej diskutimit të Kongresit IV të PPSH.<sup>5</sup> Edhe fjalimi i Manush Myftiut në këtë kongres, i botuar në faqet e "Dritës", ecën në këtë frymë.<sup>6</sup>



Këto porosi marrin zë përforcues nga figura drejtuesish të cilët përfaqësojnë studimet dhe kritikën letrare të kohës. E kur figura të tilla, si Dh. Shuteriqi legjitimojnë forcën e realizmit socialist në vetëdijen e shkrimtarëve dhe artistëve si një akt besimi,<sup>7</sup> atëhere, sigurisht që receptuesi përtyp një interpretim qëllimor si një output i metodës së vendosur. I bindur ose jo, po në funksion të kësaj linje Shuteriqi deklaron se si është të ecësh në rrugën e Partisë.<sup>8</sup>

4 R. Brahim. "Lenini - kultura dhe arti. (Duke çfletuar librin: «Lenini për kulturën dhe artin»)", *Drita*, 1961, 22 janar.

5 N. Hoxha. *Mbi bazën e traditave më të mira të letërsisë e arteve të së kaluarës po zhvillohet letërsia dhe arti i ri*. (Nga diskutimi në Kongresin e IV të P.P.Sh.) *Drita*, 1961, 19 shkurt.

6 Myftiu, Manush. "Problemet e kulturës së artit në kongresin e IV të P.P.SH", *Drita*, nr.8, f.3, 1961

7 Dh. S. Shuteriqi. "Shkrimtarët dhe artistët tanë kanë besim të plotë në forcën e socializmit". (Nga diskutimi në Kongresin e IV të P.P.SH.) *Drita*, 1961, 19 shkurt.

8 Dh. S. Shuteriqi. "Në rrugën e Partisë". (Artikull). *Drita*, 1961, 4 qershor.

SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT TANE KANE BESIM TE PLOTË NE FORCEN E SOCIALIZMIT

Nga diskutimet e shkurtër DIMITËR SHUTERIQI

Shkurtër: Udhë hezuar në këto ditë të këmbës, të këmbës... Shkurtër: Udhë hezuar në këto ditë të këmbës, të këmbës...



Shkurtër SHUTERIQI

Shkrimtarët dhe artistët tanë kanë besim të plotë në forcën e socializmit. Këtë besim e shprehin në veprat e tyre...

NE BRUGEN E PARTISE

Shkrimtari i madh që të vëmë mendje... Në rrugën e Partisë, shkrimtarët dhe artistët tanë kanë besim të plotë...

Artikujt kritikë të këtyri viti mbahen në frymën e vendimeve të kongresit, se cilën rrugë duhet të ndjekë letërsia. Këtë vendim, artikulli i rastit<sup>9</sup> kërkon ta ilustrojë nga deklaratimet e vetë shkrimtarëve. Njëherazi kjo kritikë e përcakton realizmin socialist, që po vetëmohet, si në asnjë vend tjetër, si identifikuesin simbol të artit tonë<sup>10</sup>. Këtë rrugë e përshkruan në rubrikën studime edhe R. Brahimi<sup>11</sup>.

FILLIMET E LETËRSISE SONË TE REALIZMIT SOCIALIST

Që nga numri i kaluar... Fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist... Këtë rrugë e përshkruan në rubrikën studime edhe R. Brahimi<sup>11</sup>.


me Marica me Shkurtër Pajti, të cilin... fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist... Këtë rrugë e përshkruan në rubrikën studime edhe R. Brahimi<sup>11</sup>.

Gazeta "Drita" i lë hapësirë edhe pasqyrim të raportimit mbi filmat. Ky vjetë sjell informacion mbi 12 filma: "Debatikasi", "Rruga jonë", "Mos më merr në qafë", "Evgjeni Grande", "Pasqyra e frikës", "Pesë gëzhoja", "Dama Pik", "Fati i valës së re", "Ne, fëmijët e çudirave", "Mein Kampf", "Familja Revolucionare", "Pylli i qetë".

9 "Bisedë me shkrimtarë dhe artistë". (Intervistë me rastin e diskutimit të K.Q. të P.P.Sh. mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve.) Drita, 1961, 11 qershor.
10 "Realizmi socialist - flamuri i artit tonë. Diskutime në mbledhjen për punimin e vendimit të K.Q. të P.P.Sh. Për letërsinë dhe artin, Drita, 1961, 23, 30 korrik.
11 R. Brahimi. "Fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist. Studime," Drita, 1961, 3, 10 dhjetor

Një ilustrim grafik i materialeve kritike për vitin 1961, bazuar në artikujt më identifikues (sipas tabelës përmbledhëse nr.1 në fund të punimit), do të ishte si në diagramën nr.1.

Diagramë 1 - 1961



### Viti 1962

Në letërsinë tonë të vitit 1962 vihet re po e njëjta prirje në krijimtari. Poezia është mbizotëruese dhe proza larg saj (134/43). Letërsia e përkthyer ruan raportin 37/7 të poezisë ndaj prozës dhe përkthimet sjellin në shqip poezi e tregimtari nga letërsia kubaneze, ameriko-latine, sudaneze, kongeze, japoneze, senegaleze, sovjetike, italiane, algjeriane, spanjolle, kineze etj.

1962	Letërsi shqipe			Letërsi botërore		
	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama
	134	32	1	37	7	0

Nga ana tjetër, ky vit sjell në vëmendje në numrat e gazetës vetëdijen për natyrën e kritikës. Gazeta "Drita" sinjalizon pikat se ku duhet të drejtohet kritika jonë.<sup>12</sup>


<sup>12</sup> Q. Buxheli. "Mbi disa probleme të kritikës sonë". Nga referati, *Drita*, 1962, 22 prill.; "Për një lulëzim të mëtejshëm të kritikës sonë letrare." (Kryeartikull), *Drita*, 1962, 8 prill.; "Plenum kushtuar kritikës sonë letrare". (Përmbledhje diskutimesh). *Drita*, 1962, 12 prill.; A. Abdihoxha. "Shkrimtari dhe kritika letrare." (Kryeartikull). *Drita*, 1962, 15 korrik.



Edhe për kinematografinë ky vit mban shënime për rreth 14 filma: "Kalitja", "Rroku dhe vëllezërit e tij", "Qielli i Balltikut", "Ishulli pa emër", "Ushtarë pa uniformë", "Kthesa zigzake", "Xhuzepe Verdi", "Provat e para", "Lufta dhe paqja", "Debatiku", "Kalorësit teutone", "Fati i gruas", "Xhemilja", "Kryengritësi i ri".

Artikujt kritikë në këtë vit merren konkretisht me analiza e recensione të veprave letrare e më pak me trajtime teorike. Diagrama nr. 2 ilustron prirjen e artikujve më identifikues të përzgjedhur gjatë 1962-it.

Diagramë 2- 1962



### Viti 1963

Prodhimtaria letrare e këtij viti ruan raportin mbizotërues të vargjeve mbi rrëfimin, në raportin 109/43 për letërsinë shqipe, dhe gati zhdukjen e përkthimeve në prozë. Numërohen rreth 21 tekste poetike të përkthyer dhe 1 prozë. Përkthimet vijnë nga letërsia sovjetike, afrikane, ruse, kiliane, vjetnameze, koreane.

1963	Letërsi shqipe			Letërsi botërore		
	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama
	109	43	0	21	1	0

Kritika e këtij viti diskuton mbi heroin pozitiv, për demaskimin e revizionizmit në letërsi dhe arte, si dhe tendencën për ta parë artin, letërsinë në veçanti, si mjet gëzimi, së pari, për Partinë e më pas për popullin<sup>16</sup>.

<sup>16</sup> "Demaskimi i revizionizmit në letërsi dhe në arte" *Drita*, 10 mars, 1963; Abdihoxha, Ali. "Dhe një herë mbi heroin pozitiv (një aspekt nga krijimtaria e Gorkit dhe rëndësia e tij aktuale)", *Drita*, 24 mars, 1963



Kjo është periudha e cila filtron lëvizjet që ndodhin në letërsinë sovjetike, - modeli prej të cilit vetë letërsia jonë mendoi se u krijua, duke sugjeruar që të rritet shkalla e vigjilencës, sidomos nëse ka shfaqje të ndonjë lëvizjeje të re, që kritika "puritane" nuk heziton ta quajë dekadente.<sup>17</sup> Pas kësaj çështja që kërkon të mbajë linjën e zhvillimit është letërsia për fëmijë<sup>18</sup>, sepse orientimi dhe modeli farkëtohet qysh te kjo letërsi. Në këtë vit, në shkrimet e natyrës kritike i kushtohet hapësirë edhe shqetësimit që ndihet për dramaturgjinë tonë.<sup>19</sup> Ngjarjet e rëndësishme që ndikojnë në frymën e kritikës lidhen me Konferencën Kombëtare për *Përhapjen e Shfrytëzimin e Librit* mbajtur më 24 mars dhe më 9 qershor; Mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH, apo Plenum i Dramaturgjisë dhe Teatrit.


Diagrama nr. 3 ilustron prirjen e shkrimeve kritike mbi letërsinë shqipe dhe botërore, nisur nga artikujt më identifikues të këtij viti.

<sup>17</sup> "Burimi i së keqes është revizionizmi. Mbi tendencat dekadente e formaliste që janë çfaqur në artin dhe letërsinë sovjetike gjatë viteve të fundit", *Drita*, 1963, 5 maj.

<sup>18</sup> B. Dedja. "Problem që pret ende zgjidhje. Përpara Plenumit mbi problemet e letërsisë për fëmijë", *Drita*, 1963, 1 shtator.; T. Papuçiu. "Që fëmijët tanë të kenë se ç'të lexojnë." (Mendime rreth letërsisë për fëmijë), *Drita*, 1963, 8 dhjetor.; S. Vaqari. "Për një nivel më të ngritur artistik të letërsisë për fëmijë". *Drita*, 1963, 24 nëndor;

<sup>19</sup> M. Gurakuqi. "Të flasim, pra për dramaturgjinë dhe theatrin tonë", *Drita*, 1963, 15 shtator.; "Mbi zhvillimin e tendencës realiste." (Kryeartikull. Rreth Plenumit të dramaturgjisë dhe teatrit.) *Drita*, 1963, 6 tetor; "Nga diskutimet në Plenumin e zgjeruar të punonjësve të artit dhe kulturës", kushtuar problemeve të dramaturgjisë dhe të teatrit, *Drita*, 1963, 29 shtator.

Diagramë 3 - 1963



Viti 1964

Krijimtaria letrare e vitit 1964 vijon rritjen e krijimit të vargjeve, sasi e cila gjithnjë e më shumë i largohet cilësisë. Në gazetën “Drita” identifikohen 161 tekste poetike kundrejt 38 teksteve në prozë dhe 3 teksteve dramatike, ndërsa pjesët e përkthyer kanë një rritje në raport me vitin e mëparshëm. Rezultojnë rreth 32 tekste poetike dhe 19 proza të përkthyer prej letërsive: koreane, kineze, ukrainase, afrikane, angleze, rumune, arabe, italiane, kineze, ruse etj.


1964	Letërsi shqipe			Poezi	Letërsi botërore		
	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama		Prozë (tregime, novela)	Drama	
	161	38	3	32	19	0	

Ky vit karakterizohet nga disa ngjarje që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kritikën mbi artet. I kushtohet rëndësi letërsisë për fëmijë dhe zhvillimit të saj me Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, i cili diskutoi disa probleme për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë për fëmijë.



Diagrama vijuese (nr. 4), jep ilustrimin mbi artikujt kritikë të shqyrtuar sipas listës bibliografike të vitit respektiv:

Diagramë 4- 1964



Vitet '60-të karakterizohen nga artikujt e kritikëve që japin porosi mbi direktivat se si duhet të zhvillohet letërsia. Në këtë vit (1964), ndihet shqetësimi i dekadentizmit dhe, sipas kritikëve të kohës, çdo shfaqje revizioniste në letërsinë tonë ndikon në dekadentizëm.<sup>20</sup> Këtë linjë mendimi zhvillojnë, për shembull, R. Brahimi dhe Dh. Shuteriqi. Rolin e kryeartikullit në një nga numrat e gazetës e kryen "Parimi i lartë i partishmërisë në letërsinë dhe artin tonë", artikull i cili botohet në disa numra të "Dritës".<sup>21</sup>

### Viti 1965

Asgjë e re diferencuese nuk ndodh as në këtë vit sa i përket ndryshimit në shifra të krijimtarisë letrare shqipe. Në gazetën "Drita" pasqyrohen 163 tekste poetike, 38 proza (tregime e novela) dhe 3 tekste dramatike, situatë gati e ngjashme me vitin pararendës. Afërsisht po e njëjta gjë ndodh edhe me letërsinë e përkthyer: 33 tekste poetike me 12 proza letrare, dhe asnjë pjesë nga gjinia dramatike. Përkthimet përcjellin në gjuhën shqipe pjesë nga letërsitë: italiane, ruse, vjetnameze, amerikane, bullgare, angleze, kineze, greke, rumune, domenikane, spanjolle, algjeriane, indoneziane, koreane, franceze.

1965	Letërsi shqipe			Letërsi botërore		
	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama
	163	38	3	33	12	0

<sup>20</sup> R. Brahimi. "Logjikë e çuditëshme. Qëndrimi revizionist i revistës sovjetike 'Probleme të paqës dhe të socializmit' ndaj letërsisë dhe politikës në fushën e krijimtarisë artistike", *Drita*, 1964, 12 prill; "Revizionizmi në art i çel udhën dekadentizmit", (Shënime për librin me të njëjtin titull), *Drita*, 1964, 29 mars; Dh. Shuteriqi. "Kur nuk ka cak. (Mbi rrymat iracionaliste dhe revizioniste të mendimit filozofik dhe estetik freng të sotmë dhe ndikimi i tyre në letërsi dhe art)", *Drita*, 1964, 21 qershor

<sup>21</sup> "Parimi i lartë i partishmërisë në letërsinë dhe artin tonë", kryeartikull. *Drita*, 1964, 26 korrik.



Letërsia shihet si forcë drejtuese dhe transformuese.<sup>30</sup> Për pushtetin e kohës është e rëndësishme që të mbahet një lidhje e ngushtë me letërsinë, për efektin që ajo ka për të përçuar te masat drejtimet politike sipas komuniste.<sup>31</sup>



Prandaj ajo shihet si mjete më i përshtatshëm për këtë edukim<sup>32</sup>. Vëmendje të veçantë i kushtohet po ashtu muajit të letërsisë, ku vazhdimisht ritheksohet mesazhi mbi rolin dhe misionin që duhet të mbajë përsipër krijimtaria letrare:

*"Letërsija e vërtetë është ajo që thellohet në jetën e popullit, që vihet në shërbim të tij, që shndërrohet në një armë të fuqishme për krijimin e njeriut të ri. Letërsija e re shqipe e realizmit socialist ka arritur pa dyshim, suksese të dukshme. Për sukseset e arritura nga letërsija jonë nën udhëheqjen e Partisë së Punës do të flitet gjatë mbledhjeve, konferencave, takimeve e mbledhjeve letrare që do të zhvillohen gjatë këtij muaji të letërsisë. Këtu është pikërisht rasti të pohojmë se këto suksese janë korrrë pikërisht sepse letërsija jonë e re u ka qëndruar besnike mësimëve të partisë, parimeve të estetikës marksiste-leniniste, sepse ajo ka luftue e lufton kundër estetëve borgjezë e revizionistë, për një art të partisëm, në shërbim të popullit, në shërbim të socializmit, lirisë dhe paqes".<sup>33</sup>*

Në lidhje me letërsinë botërore ky vit karakterizohet nga shkrime /përkthime të letërsisë amerikane<sup>34</sup>, rumune,<sup>35</sup>bullgare, greke, italiane, kineze etj.

Ndërsa në përmbledhjen e artikujve më identifikues të pasqyruar edhe në listën e shqyrtuar bibliografike diagrama e mëposhtme (nr. 5) paraqet prirjet e vitit:

30 K. Velça, "Transformimet e mëdha socialiste dhe letërsia", Drita, 1965, nr.35, f.2

31 "Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave", (komunikatë mbi mbledhjen e Plenumit të 15-të të Komitetit Qendror të PPSH), Drita, 1965, nr.44, f.1


32 [s.n.]. "Letërsia dhe artet – mjete i fuqishëm për edukimin komunist të masave", Drita, 1965, nr.45, f.1-2

33 Ll. Siliqi. "Muaji ynë letrar", Drita, 1965, nr.18, f.1

34 E. Kollduell. "Vjedhësi i kalit", Drita, 1965, nr.7, f.3

35 M.Kuteli, "Shkrimtari i madh rumun Ion Kreanga", Drita, 1965, nr.2, f. 4

Diagramë 5- 1965



Në përmbushje të pesëvjeçarit të parë të aktivitetit të gazetës “Drita”, të dhënat mbi botimet e letërsisë (shqipe dhe botërore) na referojnë dominuese poezinë në raport me prozën, dhe një mungesë të dukshme të teksteve dramatike në raport me dy të parat.

Përsa i përket kritikës në këtë pesëvjeçar, forcohen dukshëm tiparet e analizuara më sipër, si:

1. Kritika e përdor letërsinë si *mjet propagandimi*, jo vetëm kur u referohet modeleve që ajo duhet të zbatojë apo teorive të saj, por edhe në vetë orientimet për botimet e reja.

2. Kritika synon forcimin e *realizmit socialist* dhe përparon në krijimin e një vetëdijeje krijuese të karakterizuar nga militantizmi.


3. Me anë të porosive për mënyrën e krijimit, *kritika e orienton autorin* drejt tematikave që ruajnë traditën, transformimeve të mëdha socialiste dhe ndërtimin e modelit të romanit për masat.

Grafikët e mëposhtëm ilustronjë pamjen e botimeve/pjesëve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore në faqet e gazetës “Drita”, në pesëvjeçarin e parë të aktivitetit të saj:

Diagramë 6 – Prirjet e kritikës dhe letërsisë në pesëvjeçarin 1961-1965 te gazeta “Drita”



Diagramë 7- Prirjet e botimeve kritike dhe krijuese mbi letërsinë botërore në pesëvjeçarin 1961-1965 te gazeta "Drita"



## Rast studimi

### Debati mbi novatorizmin në faqet e gazetës “Drita”

I ashtuquajhuri “debat mbi novatorizmin”, shtrihet përgjatë disa muajve të vitit 1961 në gazetën “Drita”, por çështja e termit novatorizëm i ka rrënjët në kontekstet më të hershme, së pari, politike, e për rrjedhojë edhe letrare e kulturore të Bashkimit Sovjetik. Raporti i famshëm i N. Hrushovit në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (shkurt 1956), i titulluar “Mbi kultin e individit dhe pasojat e tij” ka parashtruar tashmë për të gjithë kampin socialist domosdoshmërinë e “korigjimit” të linjës staliniste në të gjithë sferën publike, nga politika e ekonomia deri te shkencat e artet. Letërsia do të sprovtojë kërkime të reja të shprehjes drejt një lirie më të madhe e subjektiviteti më të thellë, një vetëdije të re, si në shkrimin letrar edhe në ligjërimin kritik. Por shteti shqiptar i mbetet besnik Stalinit e stalinizmit me përpikmëri, duke mos lejuar asnjë “qortim” e “revizionim” të mundshëm askund, as në letërsi e arte. Pikërisht në këtë kontekst marrin kuptim një varg përkufizimesh thujtase identike e me ngjyresa kërcënuese që i bëhen termit “novatorizëm” nga ligjërimi zyrtar, në dokumente politike ose kulturore, si nga figurat kryesore të Partisë së Punës ashtu dhe nga drejtuesit kryesorë të Lidhjes.

Raporti i mbajtur nga Dh. Shuteriqi në Kongresin I të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë më 1957, ndonëse nuk i referohet letërsisë shqipe, sinjalizon shqetësimin ndaj dukurisë së “novatorizmit” si dhe një paralajmërim të mundshëm për të mos e pretenduar kurrsesi atë në letërsinë e artin shqiptar.<sup>1</sup> Formula e një “letërsie kompakte ideologjike” është e plotë: nuk ka revizionim në politikën tonë, nuk ka revizionim në letërsinë tonë. Novatorizmi, i kuptuar sidomos përmes kërkimeve të tija formale, nuk është as i dëshirueshëm e as i pranueshëm.

Ndonëse gjatë këtyre viteve, në faqet e revistës “Nëndori” janë botuar disa fjalime të Hrushovit, ku herë më shkoqur e herë më zbehtë do të parashtrohet ndryshimi i qasjes ndaj dogmës së realizmit-socialist, në qëndrimin e udhëheqësve

---

1 “[...] në botën e sotme borgjeze dhe jo vetëm borgjeze, bëhet një zhurmë aqë e madhe për “novatorizëm”, ky “novatorizëm”, i kuptuar jashtë ose larg jetës, si një lojë e thjeshtë me ngjyrat dhe me tingujt, apo si grumbullim fjalësh pa kuptim, nuk sjell asgjë të re në art, përveç gjërave pa kuptim dhe zakonisht të shëmtuara, që prodhon sot aqë shumë i ashtuquajhuri art i “novatoristëve” borgjezë. Ne, sigurisht, nuk na ngjet kështu. Ne nuk nisemi nga dëshira boshe për të inovuar. Ne nisemi nga nevoja për të shprehur jetën në art”, Dhimitër Shuteriqi, “Mbi zhvillimin e letërsisë dhe arteve dhe detyrat për të ardhmen”, Vep.Cit., f.18

politikë shqiptarë, si dhe në ligjërimin e autorëve e të kritikëve, novatorizmi mbetet një formulim i paqartë, i mbërthyer mes paralajmërimit kërcënues nga njëra anë, dhe reduktimit të tij nga ana tjetër, në një luftë mes dy brezash poetësh, ku paradoksalisht, jo të rinjtë, por të vjetrit hidhen në sulm për të mos u bërë të padukshëm në emër të novatores. Veçanërisht gjatë viteve '58-'59, revista "Nëndori", përmes anketës së saj me titull "Ç'mendoni ju për poezinë e sotme"<sup>2</sup>, do të bëhet tribunë e një ligjërimi konservator mbi poezinë, ku përgjithësisht poetëve të rinj nuk u kursehen qortimet<sup>3</sup> në emër të poetikave tradicionale dhe parimeve të shëndosha të realizmit-socialist. Nuk mungon, sidoqoftë, as ndonjë kritikë pozitive, si në rastin e shkrimit pro të rinjve të A. Myftiut<sup>4</sup>, apo përpjekja e kujdesshme për të parashtuar një koncept më të emancipuar për lirikën dhe novatorizmin në të, si në rastin e shkrimit të Drago Siliqit (poet e kritik), me titullin "Për një poezi të thellë e militante"<sup>5</sup>, mbas mbylljes së anketës. Por kjo përpjekje ngjan se nuk rezulton e suksesshme.

Kongresi IV i PPSH-së, zhvilluar në shkurt të vitit 1961, rikthen haptazi qëndrimin e ligjërimin kërcënues ndaj novatorizmit. Këtë gjë e pohojnë edhe fjalimet e ministrit të Arsimit, Manush Myftiu dhe të Nexhmije Hoxhës. M. Myftiu deklaroi se, "është e ditur që ne nuk jemi kundër të resë [...], por ne jemi kundër asaj të reje që shtrembëron realitetin, deformon të vërtetën, shëmton e përçmon bukurinë dhe artin"<sup>6</sup>, ndërsa për N. Hoxhën "partia kujdeset që në ideologji, kulturë, art, letërsi etj., mos të depërtojnë influencat e huaja, sëmundjet a mania e modernizmit për modernizëm"<sup>7</sup>.

Por vetëm një muaj më pas, më 19 mars, në gazetën "Drita" nis botimi i artikullit të gjatë e deri diku provokator "Fryma e kohës në letërsinë tonë" i poetit të ri Agim Shehu. Artikulli mbështetet mbi krijimtarinë e një grupi poetësh të rinj, të formuar në shkollat e larta të Bashkimit Sovjetik e vende të tjera të Kampit Socialist, për të argumentuar se letërsia shqipe po përtërinte vetveten përmes "tendencës për forma të reja të pasqyrimit poetik të jetës, kërkim mënyrash e mjetesh artistike të gjalla, dinamike dhe sintetike, për një shprehje të ngjeshur metaforike, mbrujtur me idetë e mëdha të kohës sonë. Kjo formë më e re dhe më e pasur rrjedh nga një përmbajtje më e pasur dhe e pasqyron atë"<sup>8</sup>.

Artikulli, me gjithë ftesën e redaksisë<sup>9</sup> për dialogim, nuk merr asnjë përgjigje publikisht, por dy muaj më pas, KQ i PPSH shpall Vendimin e 22 majit: "Mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve", në të cilin formulohet një qëndrim zyrtar më i prerë e më rezonues me deklaratimet paralajmëruese të Kongresit IV.

2 "Ç'mendoni ju për poezinë e sotme", *Nëndori*, nr.5, 1958

3 Bien në sy shkrimet e F. Ndocaj, A. Varfi, M. Gurakuqi.

4 Myftiu, Abdurrahim. "Shënime për poezinë e sotme", *Nëndori*, nr.9, 1958

5 Siliqi, Drago. "Për një poezi të thellë e militante", *Nëndori*, nr.5, 1959

6 Myftiu, Manush. "Fjala e shokut Manush Myftiu", *Nëndori*, nr.3, 1961, f.49

7 Hoxha, Nexhmije. "Fjala e shoqes Nexhmije Hoxha", *Po aty*, f.66

8 Shehu, Agim. "Frymë e kohës në poezinë tonë", *Drita*, 19 mars, 1961

9 Shënimi i redaksisë: "Në artikullin "Frymë e kohës në poezinë tonë" krahas çështjeve të drejta e parimore, mund të ketë edhe mendime të diskutueshme. Ftojme shkrimtarët, ata që merren me kritikë e këdo që do të dëshironte, të çfaqin mendimin e tyre rreth problemeve të poezisë sonë të sotme.", *Drita*, 19 mars, 1961

Novatorizmi edhe lejohej, edhe kërcënohej: lejohej si nevojë për ta pasuruar realizmin socialist, kërcënohej me shpalljen "formalist e armiqësor".<sup>10</sup>

Dy javë pas botimit të Vendimit, më 18 qershor, krahas artikullit të Fatmir Gjatës me titull "Të ecim me hapin e kohës", një komentim pohues i vendimit, botohet edhe artikulli i gjatë i Drago Siliqit, me titullin "Në kërkim të së resë"<sup>11</sup>. Autori e sjell termin "novatorizëm" në kuptimin e kërkimit individual të së resë: "Vetëm nëpërmjet kërkimeve individuale të shkrimtarëve më të ndryshëm letërsia ngrihet deri në shkallën e edukimit estetik të njerëzve, me anën e pasqyrimin të saj të veçantë. Aty ku fillon uniformiteti dhe rutina, aty mbaron letërsia si art dhe sa më i dobët të jetë individualiteti artistik në një vepër letrare, aq më e vogël dhe e dobët është rrezja e saj e pasqyrimin, aq më pak emocionon, pra edhe edukon." Në këtë shkrim programatik mbi novatorizmin në gjirin e realizmit socialist, përmes formulimeve "kërkim individual" dhe "pasqyrim i veçantë" zgjerohen disi parimet e ngurta të realizmit socialist, si ai i pasqyrimin dhe marrëdhënia formë-përmbajtje, duke i njohur artit forcën krijuese dhe vlerën estetike në pasqyrimin e realitetit.

Artikullit, në një mënyrë disi të tërthortë do t'i përgjigjet pa humbur kohë Shevqet Musaraj në faqet e "Nëndorit", përmes artikullit "Perspektiva të mëdha", një vijim i diskutimeve për Vendimin e 22 majit, në të cilin ripohohet jo vetëm padobishmëria, por edhe "rrezikshmëria e novatorizmit" për letërsinë shqipe.<sup>12</sup> Në rezonim të plotë me formulimet e N. Hoxhës, M. Myftiut, Dh. Shuteriqit, autori merr një pozicion konkret në debat.

Të gjendur përpara një "debati publik"<sup>13</sup>, krejt të panjohur më parë, institucionet partiake vendosin të ndërhyjnë me rolin e ekulibristit për të thënë fjalën e fundit (e zyrtare) mbi çështjen e novatorizmit. Në mbledhjen e gjerë të 11 korrikut për punimin e vendimit të KQ "Mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe artit", zhvilluar me

10 "Përpkjet që po bëhen nga disa shkrimtarë e artistë drejt novatorizmit në poezi, pikturë, grafikë, etj. duhet të frymëzohen kurdoherë nga qëllimi për të pasuruar letërsinë dhe artin tonë të ri, duke u mbështetur në trashëgiminë më të mirë letrare të popullit tonë dhe gjithnjë mbi bazën e realizmit socialist. Partia përkrah çdo gjë të re, të bukur e të shëndoshë, duke luftuar njëkohësisht çdo tendencë formaliste e armiqësore për artin tonë të ri socialist. Lidhja e shkrimtarëve dhe e artistëve, organet e saj të shtypit nëpërmjet diskutimeve, kritikës etj. të ruajnë radhët e tyre nga çdo depërtim i influencave të huaja të artit të sotëm borgjez dhe revizionist, nga mania e imitimit të të ashtuquajturit modernizëm dhe të tendencave të tjera që janë të huaja për ne, që i heqin artit përmbajtjen e fuqinë për ta edukuar njeriun me ndjenja e virtute të larta njerëzore e socialiste", "Vendimi i KQ, "Mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve", *Nëndori*, nr.6, 1961, f.7

11 Siliqi, Drago. "Në kërkim të së resë", *Drita*, 18 qershor, 25 qershor, 2 korrik, Tiranë, 1961

12 "Novatorizëm për novatorizëm, pra, novatorizëm formalist, i çkëputur nga traditat dhe i xhveshur nga karakteristikat kombëtare dhe nga karakteri popullor në letërsi dhe arte është tendencë që shpie në labirint dhe rrugë pa krye të të ashtuquajturit modernizëm, në ermetizëm, në paqartësinë e artit, pra edhe në paaftësinë e tij që të lozë rolin e farkëtarit të shpirttrave njerëzorë.", Shevqet Musaraj, "Perspektiva të mëdha", *Nëndori*, nr. 7, 1961 f.13

13 "Siç po lexojmë në shtyp e po dëgjojmë andej këndeje, në rrethet tuaja kanë lindur disa diskutime mbi novatorizmin në art. Në qoftë se diskutimi zhvillohet mbi baza parimore e në frymë shoqërore, letërsia dhe artet nuk kanë asnjë dëm; përkundrazi. Ramiz Alia, "Mbi disa çështje të letërsisë dhe arteve", *Nëndori*, nr. 8, Tiranë, 1961, f.33

shkrimtarë e artistë në mjediset e Lidhjes, në referatin kryesor, i cili i ngjan në thelb një manuali përdorues<sup>14</sup> të vetë Vendimit, Ramiz Alia shqipton njëkohësisht edhe "pranimin" edhe "kërcënimin" ndaj novatorizmit [të të rinjve] duke pohuar se për Partinë është madje vetë "metoda e realizmit socialist [ajo që] nënkupton dhe siguron një larmi të pakufishme stileshe dhe individualitetesh artistike. Ajo e siguron novatorizmin".<sup>15</sup> Në fund të raportit, novatorizmi përkufizohet thujtë si një sinonimi i realizmit socialist ku "veprat e talentuara që ecin në rrugën e novatorizmit të vërtetë, përbëjnë në tërësi atë art novator që ne e quajmë art i realizmit socialist".<sup>16</sup> Poetëve të brezit "të vjetër" u jepet sinjali i "tërheqjes". Ndërsa fjalimi përmbyllës i Enver Hoxhës, tekta pohon rëndësinë që kanë të dyja palët në sytë e Partisë, u kujton gjithashtu se sa rrezikojnë tashmë pavarësisht krahut të debatit ku ndodhen: "unë desha t'i them edhe të vjetërve edhe të rinjve se, në qoftë se do të bëjnë vjersha që u përngjasin atyre që bëjnë dekadentët borgjezë, kjo do të jetë me të vërtetë e neveritëshme; vjersha të tilla janë për t'u hedhur poshtë, sepse ato e pengojnë zhvillimin e poezisë sonë dhe i edukojnë keq masat."<sup>17</sup>

Por debati mes poetësh do të vijojë edhe pak javë më tej në faqet e gazetës "Drita". Mark Gurakuqi<sup>18</sup> vazhdon sulmin e "poetëve të vjetër" kundër novatorizmit të rrezikshëm të të rinjve, ndërsa Dritëro Agolli<sup>19</sup>, në emër të këtyre të fundit, kundërpërgjigjet në artikullin e vet me shembuj konkretë poezish të dobëta, të rëndomta e thujtë qesharake, të qëmtuara nga veprat e "të vjetërve".

Debati mbyllet po aq papritmas sa filloi. Në të njëjtën fletë të "Dritës" ku mbaron artikulli i gjatë i Agollit, poeti Mark Gurakuqi, pohon me vargjet e poezisë "Shokëve të rinj poetë"<sup>20</sup>, se "Me zemër t'haptë do u dorzojm' stafetën". Po aq mediokre sa shembujt që citonte pa kursyer Agolli, poezia është një rishkrim poetizues i "manualit" të R. Alisë.

Më 22 tetor shpallet ndarja nga Bashkimi Sovjetik. *Sic transit gloria mundi!*

14 "Raporti që mbajti në këtë mbledhje shoku Ramiz Alia, duhet të konsiderohet si diçka që plotëson vendimin e KQ të Partisë mbi letërsinë dhe artet", Enver Hoxha, "Nga fjala e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e gjërë me shkrimtarët dhe artistët", Po aty, f.11

15 "Ta zhvillojmë pra artin, t'i hapim rrugë novatorizmit në art, por, nën maskën e novatorizmit të mos lejohet të minohet vetë arti. Ky është qëndrimi i drejtë që duhet mbajtur në këtë çështje. Do të gabonin ata që do të qëndronin në vend dhe frenonin veten e të tjerët. Do të gabonin edhe ata që do të mendonin se mund të ndërtohen këshjtjella në hava. Veçanërisht në kushtet e sotme, kur ideologët e borgjezisë dhe revizionistët reklamojnë me të madhe lloj-lloj ide dhe forma gjoja të reja, duhet të tregojmë pjekuri e vigjilencë të lartë ideo-artistike ndaj çdo lloj novatorizmi fallco. Novatorizmi i vërtetë që njeh ligjet e zhvillimit në shoqëri e në art, që nuk shkëput të renë nga tradita, që nuk ndan formën nga përmbajtja, ky novatorizëm çon përpara letërsinë dhe artet.[...]", Ramiz Alia, "Mbi disa çështje të letërsisë dhe arteve", Po aty, f.34

16 Po aty, f. 6

17 Hoxha, Enver. "Nga fjala e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e gjerë me shkrimtarët dhe artistët", Po aty, f.13

18 Gurakuqi, Mark. "Traditë dhe novatorizëm", *Drita*, 30 korrik, 1961

19 Agolli, Dritëro. "Traditë, natyrisht, por jo shtampë", *Drita*, 27 gusht – 3 shtator, 1961

20 Gurakuqi, Mark. "Shokëve të rinj poetë", Po aty: *Në sofrën e përbashkët t'poezisë / Ju vini me at hovin djaloshar / Me ritmet e guximshëm të rinisë, / Filiza t'rij të truellit shqipëtar. / Me zemër t'haptë do u dorzojm' stafetën / Ajo do bierë në t'sigurat duer, / Le t'jetë vargu i ynë bajonetë / E bombë për armiq – për në Flamur!*

## 5.2 Vitet 1966-1970

### Viti 1966

Tema mbizotëruese e teksteve të letërsisë shqipe të botuara në faqet e gazetës “Drita” edhe këtë vit vijon të mbetet e lidhur me aktet heroike gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, me begatinë që po i siguron popullit partia në pushtet, si dhe me “farkëtimin” e njeriut të ri. “Drita”u jep hapësirë diskutimi vendimeve dhe orientimeve që dolën nga Plenumi i vitit të mëparshëm. Një ide mbi botimet kritike dhe letërsinë shqipe dhe botërore na krijon tabela me të dhënat e mëposhtme:

Letërsi shqipe				Letërsi botërore		
1966	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama
	116	32	0	24	8	0

Këtë vit nis qarkullimi i shkrimtarëve nëpër degët e Lidhjes, në disa nga rrethet e vendit, për të forcuar lidhjen e pretenduar dhe të detyruar të shkrimtarit dhe kritikut me masat punonjëse. Ngjarjet politike të pasqyruara në faqet e gazetës ndjekin agjendën politike të ditës dhe lidhen konkretisht me Plenumin XVI të KQ dhe Kongresin V të PPSH-së, i cili thekson forcimin e diktaturës së proletariatit dhe kërkon një revolucionarizim shumëplanësh.

Një nga çështjet e konsideruara me rëndësi të veçantë për redaksinë, aq sa të shfaqet nën autorësi të ndryshme në disa numra të gazetës, është çështja e partishmërisë së letërsisë. Kështu, nën titullin “Si lindi letërsia e partishme?”<sup>1</sup> paraqesin zbërthimin e direktivave partiake autorë si: Andrea Varfi, Aleks Çaçi etj.



1 [s.n.], “Partishmëria-parim themelor i letërsisë sonë”, *Drita*, 1966, nr. 42, f. 1 ; A. Varfi, “Si lindi letërsia e partishme”, *Drita*, 1966, nr. 42, f.3 ; A. Çaçi, “Si lindi letërsia e partishme”, *Drita*, 1966, nr.43, f.3.



Fokusi i kritikës bëhet proza: romani dhe tregimi. Nga artikujt kushtuar letërsisë, rreth 10 më të rëndësishmit<sup>2</sup> prej tyre trajtojnë problemet e romanit, të tjerë të tregimit e më pak të poezisë, edhe pse poezia ende vijon të jetë më e botuara.

Poetët: P. Budi, A.Z. Çajupi, N.Mjedja e Migjeni janë figura mbi të cilat shkruhen artikuj kritikë-studimorë. Në këtë vit janë 28 artikuj kushtuar artit dhe kinemasë, përtej artikujve kritikë kushtuar vetëm letërsisë. Letërsia botërore do të përthyeret në dy-tre artikuj që mbulojnë Roman Rolandin francez apo poezinë e Brehtit;<sup>3</sup> si edhe përkthime prej frëngjishtes, anglishtes dhe rusishtes, kryesisht.<sup>4</sup>


Diagrama e radhës (nr.8) na ilustron raportin midis artikujve kritikë të letërsisë shqipe dhe asaj botërore, sipas listës bibliografike të vitit respektiv.

2 D. Hasani, "Anketë mbi probleme të romanit tonë", *Drita*, 1966, nr.1, f.2; A. Kallulli. "Domosdoshmëria dhe rastësia në romanin tonë", (drejt Plenumit kushtuar problemit të romanit), *Drita*, 1966, nr.3, f.1; Z. Risto. "Anketë për probleme të romanit tonë", *Drita*, 1966, nr.3, f.2; Xh. Abazi. "Fytyra e kohës në roman", (Anketë për romanin...), *Drita*, 1966, nr.4, f.2; N. Jorgaqi. "Pikënisja e autorit dhe logjika objektive e personazheve", (drejt Plenumit...), *Drita*, 1966, nr. 6, f.2; V. Melo. "Mbi koherencën e karakterit në roman", (drejt plenumit), *Drita*, 1966, nr.15, f.2; [s.n]. "Mbi zhvillimin e prozës sonë", (Plenum i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve), *Drita*, 1966, nr.17, f.1; D. Shaplllo. "Për zhvillimin e mëtejshëm të prozës dhe të kritikës tonë", *Drita*, 1966, nr.18, f.1A; K. Bihiku. "Në rrugë të shtrëmbër", (kritikë mbi romanin "Tuneli" të Dh. Xhuvanit), *Drita*, 1966, nr.25, f.2; [s.n]. "Mbi romanin 'Stina e armëve'", (kritikë), *Drita*, 1966, nr.28, f.2,4; A. Fortuzi. "Probleme ideore të romanit tonë", (kritikë), *Drita*, 1966, nr.32, f.2

3 M. Xhaxhiu, "Romen Roland-figurë e çqar e letërsisë frënge", (kritikë), *Drita*, 1966, nr. 6, f.3; K. Shuman. "Poezia e Brehtit", (kritikë nga shtypi i huaj), *Drita*, 1966, nr.8, f.4

4 A. Gançarov, "I. Oblomovi", përkth. prej rusishtes, roman; Huu Mai. "Lartësia e fundit", roman, përkth.nga frëngjishtja; V. B. Ibanez, "Kasollja", roman, përkth. nga anglishtja; A. Xh. Kronin, "Citadela", roman.; Popov, V. "Çeliku dhe zgjyra", roman, përkth. nga rusishtja; B.Apitz. "Lakuriq në mes të ujërve", roman, përkth. nga gjermanishtja; Ai Bui Dyk. "Gruaja e re e Bai Saos", – nga frëngjishtja; "Do të ndjek rrugën tënde", përkth. prej frëngji; V. N. Gogol, "Taras Bulba", novelë; E. Kollduell. "Në shtëpinë tonë", roman, përkth. prej rusishtes; G. Perlteev, "Skënderbeu"- poemë; T.Vishnjovski, V. "Tragjedia optimiste", pjesë në tre akte kushtuar XV-vjetorit të Ushtrisë së Kuqe, përkth. nga rusishtja Dh. Pasko.

Diagramë 8- 1966



### Viti 1967

Në shkurt të vitit 1967, fjalimi i Enver Hoxhës mbi fenë do të shënjojë një tjetër linjë orientimi mbi mënyrën sesi do ta ndryshojë pamjen edhe letërsia. Udhëzuesi i hartuar në muajin gusht të këtij viti nga sektori i Edukimit të KQ të PPSH-së, drejtuar komiteteve të rretheve; zhvillimi i punimeve të Plenumit të 3-të të KQ të PPSH-së në tetor, organizimi i Kongresit të 6-të i BGSH-së, së bashku me përkujtimin e 50 vjetorit të revolucionit socialist të tetorit, të gjitha këto do të ndikojnë në orientimin e letërsisë dhe arteve të tjera në raportet e tyre me masat, veçanërisht mbi rolin edukues të masave që të parat duhet të bëjnë pandërprerje.


Gjatë këtij viti kemi këtë situatë botimesh:

1967	Letërsi shqipe			Letërsi botërore		
	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama
	112	43	0	23	1	0

Kryefjalë e artikujve kritikë është revolucionarizimi, thellimi në interpretimin ideologjik të letërsisë dhe arteve duke i dhënë përparësi veçanërisht dramaturgjisë, e konsideruar si një mjet efikas e i drejtpërdrejtë në funksion të edukimit të masave. Teatri/estrada janë llojet zhanrore që promovohen për të arritur pa ndërmjetësim komunikimin me publikun e gjerë.

Diagrama në vijim (nr. 9), ilustron raportin e shkrimeve kritike/pjesëve letrare të letërsisë shqipe, sipas artikujve të shqyrtuar nga viti përkatës:

Diagramë 9- 1967



Letërsia botërore shënon katër artikuj të shqyrtuar që lidhen me çështjet teorike apo artikuj kushtuar prozës.


#### Viti 1968

Pas vendimeve të marra në vitin e mëparshëm, viti 1968 vjen me rritje të pjesëve poetike në raport me vitin pararendës. Këtë vit, për letërsinë shqipe numërohen rreth 161 poezi, kundrejt 36 teksteve në prozë dhe 2 tekste dramatike, ndërsa, për letërsinë botërore ruhet raporti 31 (tekste poetike), me 21 (prozë). Diagramet e mëposhtme ilustronë këtë ndarje:

Diagramë 10 Botimet krijuese e kritike-letërsi shqipe, 1968



Diagramë 11 Botimet krijuese e kritike-letërsi botërore, 1968



Kritika e këtij viti e sheh realizmin socialist si një realitet partiak. Kërkohej dalja nga prapambetja e njëherazi vijimi i revolucionit vendas, pasi artit modern "të vendeve kapitaliste" i vihet bllokim. Gjithashtu kritika synon të theksojë drejtimin e letërsisë dhe të arteve për edukimin revolucionar shkollor dhe jashtëshkollor.<sup>5</sup> Kuptohet që kritika në zërin e prozës nënkupton edhe kritikën, edhe teorinë e saj.

<sup>5</sup> R. Idrizi. "Nevoja e studimit më të thellë të letërsisë së realizmit socialist dhe të periudhave të zhvillimit të saj", *Drita*, 1968, 9 qershor

Viti 1969

Ngjarjet kulturore që shënon ky vit lidhen më së pari me mbajtjen e Kongresit të Dytë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Në muajin nëntor filloi punimet edhe Konferenca Kombëtare e Studimeve Shoqërore, me pjesëmarrjen e Enver Hoxhës dhe udhëheqësve të tjerë të partisë dhe shtetit. Sa i takon Letërsisë, ajo ruan raportet e mëparshme në sasi mes poezisë dhe prozës.

Letërsi shqipe				Letërsi botërore		
1969	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama
	167	38	2	32	14	0

Viti 1969 është një vit me sasi të konsiderueshme të artikujve kritikë që reflektojnë zhvillimet e letërsisë në vend e pak atë jashtë tij. Mbi 80 artikuj mbulojnë letërsinë, dhe specifikisht shtatë prej tyre u kushtohen arteve të tjera si, muzikës për fëmijë, kritikës së saj, apo prodhimeve kinematografike të lidhura me letërsinë vendase.<sup>6</sup> Kritika e këtij viti merr përsipër mbrojtjen e masës nga rreziqet që i vijnë nga teatri dhe kinemaja botërore. Duke e parë këtë si degjenerim të llahtarshëm, apo duke e konsideruar çdo gjë të jashtme si të dëmshme<sup>7</sup>, kritika e orienton gjithë vëmendjen drejt artit vendas të formatuar sipas direktivave partiake.



Ky është viti kur kritika kërkon drama dhe të diskutojë rreth tyre. Po aq kërkon që të forcohet ideja e prodhimit tonë filmik, i cili materialin e merr prej vetë kësaj letërsie të orientuar. Ndërsa shembujt e mbijetesës si Solzhenicini shihen si "karta të djegur"<sup>8</sup>.


6 Cefa, Sander; Betoja, Albert. "Festivali artistik kombëtar i fëmijëve e pionerëve dhe disa probleme kritike", *Drita*, nr.30, 30 korrik, f.2; Qirku, Andon. "Përshtatje muzikore me psikologjinë e fëmijëve", *Drita*, nr.31, 27 korrik, f.2; Zadeja, Çesk. "Përmbajtja emocionale i jep këngës përcaktim shoqëror", *Drita*, nr.32, 3 gusht, f.2; Minga, Albert. "Aktori realist i kinematografisë sonë", *Drita*, nr.33, 10 gusht, f.4; Papagjoni, Josif. "Njësite guerrile", filmi, *Drita*, nr.51, 14 dhjetor, f.4

7 Varfi, Andrea. "Pamje revoltuese të realitetit kapitalist", *Drita*, nr.2, 12 janar, f.5

8 "Agjenti i borgjezisë dhe kundërrivolucionit Solzhenicini, një kartë e djegur", *Drita*, nr.50, 7 dhjetor, f.5

Grafikisht prirjet e botimeve kritike të shqyrtuara, referuar listës bibliografike në fund të këtij botimi, si edhe referuar gjinive, shfaqen si më poshtë:

Diagramë 12- 1969



### Viti 1970

Në muajin mars të këtij viti realizohet takimi kombëtar për letërsinë, ndërsa në qershor mbahet Plenumi X i KQ.

Ky vit, në pasqyrimin e gazetës "Drita", ka një prurje të tillë:

Letërsi shqipe				Letërsi botërore		
1970	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama	Poezi	Prozë (tregime, novela)	Drama
	163	34	4	34	11	0


Artikujt kritikë mbulojnë jo vetëm letërsinë vendase, por edhe atë të huaj, si dhe problemet e arteve të tjera. Interesohet kjo kritikë për muzikën, filmin, dramën po ashtu. Në rreth 124 artikuj, ku përfshihen edhe artet e tjera, rreth 15 syresh i kushtohen muzikës dhe filmave. Mbi letërsinë vendase dhe të huaj, poezia dhe drama trajtohet më shumë së vitet e mëparshme, por, sigurisht, më pak se kritika mbi prozën apo mbi problemet teorike të artit të krijimtarisë.



Në mënyrë ilustrative këto të dhëna shprehen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:


	kritikë-mbi letërsinë shqipe/fragmente				kritikë mbi letërsinë botërore/		
	poezi	prozë	dramë		poezi	prozë/teo	dramë
1970	11	49	12		1	11	2

*Diagramë 13- Kritika / fragmente të krijimeve rreth letërsisë shqipe dhe botërore, 1970*



Ky dhjetëvjeçar, në prirjen e tij kritike mban këtë trajektore mbi letërsinë shqipe dhe botërore. Shih grafikun nr.14.

*Diagramë 14*





## 5.3 Vitet 1971-1975

### Viti 1971

Ngjarja kryesore që karakterizon këtë vit është Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, mbajtur më 25-26 janar 1971, tek i cili njëri nga vendimet ishte "Hartimi dhe publikimi në muajin korrik i projektdirektivave të kongresit për planin pesëvjeçar (1971-1975) të zhvillimit ekonomik dhe kultural në vend".<sup>1</sup> Ky vendim lidhet drejtpërsëdrejti me rrugën që do t'i diktohet artit dhe letërsisë. Së dyti, më 1 nëntor 1971 organizohet kongresi i 6-të i Partisë. Ngjarjet në fjalë reflektohen në artikuj si: "Me ty Parti marshojmë fitimtarë drejt horizonteve të reja", dhe nëntitull "Rroftë Kongresi i 6-të i Partisë".<sup>2</sup> Vetë kontrolli që Partia i bën letërsisë dhe arteve shfaqet në artikuj ku udhëheqësit marrin rol të drejtpërdrejtë: "Shoku Ramiz Alia flet mbi detyrat themelore që rrjedhin nga Kongresi i Gjashtë i Partisë"<sup>3</sup>. Në këtë spektër kontrolli të arteve, dënimin do ta marrë një vit më vonë dhe Festivali i 11-të i Këngës, mbajtur më 22-25 dhjetor 1972.

Viti 1971 karakterizohet gjithashtu edhe nga disa ngjarje të cilat lidhen me punimet e Konferencës së Pestë të Bashkimit të Gazetarëve të Shqipërisë<sup>4</sup>; me 30-vjetorin e Partisë dhe Kongresin e saj të 6-të<sup>5</sup> si edhe me ruajtjen e frymës ideologjike në konceptimin e artit dhe të letërsisë në veçanti<sup>6</sup>. Madje, në këtë aspekt, shkrimet kritike synojnë thellimin e përmbajtjes ideologjike të letërsisë sonë.<sup>7</sup>



1 Po aty

2 *Drita*, 31 tetor, 1971

3 *Drita*, 6 shkurt, 1972

4 ATSH, *Drita*, 1971, 6 qershor, f.1-2, nr.23

5 *Drita*, 1971, 6 qershor, f.1-7, nr.23; 27 qershor, f.1, nr.26

6 "Mao Ce Duni mbi letërsinë dhe artin *Drita*, 1971, 27 qershor, f.8, nr.26

7 "Të thellojmë më tej përmbajtjen ideologjike, artistike dhe profesionale të kritikës sonë letrare", *Drita*, 1971, 13 qershor, f.1, nr.24

Fokusi i kritikës është se si letërsia jonë, qoftë proza, qoftë poezia, të qëndrojë në frymën e saj popullore.<sup>8</sup> Po të ndërmendim karakterin intim, metafizik e filozofik që e shenjon poezinë, vetëkuptohet se sa larg në tjetërsim e shpien atë direktivat e kësaj kohe. "Në poezinë tonë të re pasqyrohet lufta e vetëdijshme e popullit për ndërtimin e socializmit, duke e parë veten si zot të fatit të vet. Heronj të rëndësishëm janë fshatarët, të cilët janë edhe më të gjallë dhe më të kristalizuar artistikisht. Karakteri popullor i poezisë sonë shprehet në kërkimin e pandërprerë të formave të reja në përputhje me nivelin estetik, gjithmonë në ngritje të masave dhe pa u shkëputur nga rrënjët kombëtare"<sup>9</sup>

Në vijim të logjikës së letërsisë së partishme, shfaqen artikuj që analizojnë heroin



në raport me partishmërinë, heroin dhe realizmin socialist. "Ideali pozitiv ka lidhje me partishmërinë, që është parimi kryesor i metodës së realizmit socialist. Partishmëria ekziston edhe në qendër të një vepre kur nuk është heroi pozitiv". Autori i artikullit nënvizon faktin se, edhe aty ku nuk ka hero pozitiv (këtë autori i shkrimit e ilustron me shembuj të ndryshëm nga P.Marko, I.Kadare etj.), ku në qendër është një tip negativ, partishmëria është e madhe<sup>10</sup>, duke e parë (kthyer) edhe "të ndryshmin" në funksion të partishmërisë.

Nga ana tjetër, vijojnë të jepen drejtime sesi vetë kritika duhet të jetë më e thellë, jo sipërfaqësore, duke iu larguar globalizmit dhe e shtrirë edhe në artet e tjera.<sup>11</sup> Lidhur me kërkesat e fundit mund të veçohen 19 artikuj kushtuar skulpturës, 39 muzikës dhe 19 kinematografisë.

8 N. Lezha, "Mbi karakterin popullor në letërsinë tonë", *Drita*, 1971, 28 shkurt, f.1, nr.9  
 9 K Kodra. "Mbi karakterin popullor të poezisë sonë të viteve të fundit, *Drita*, 1971, 14 shkurt, f. 2-7, nr.7 ; I. Dono, "Mbi karakterin popullor të poezisë sonë, *Drita*, 1971, 7 mars f. 2, nr.10  
 10 A. Polovina, "Heroi dhe partishmëria." (Mendime), *Drita*, 1971, 23 maj, f.2, nr.21  
 11 P. Mele, "Kritika dhe problemet e krijimtarisë". (Në artet figurative). *Drita*, 1971, nr.28, 11 korrik, f.6

## Viti 1972

Në këtë vit kritika artikulohet në raport me teorinë<sup>12</sup> dhe sesi të programohet rritja e cilësisë së saj.



Fokusi i saj bëhet edhe muzika me filmin, respektivisht rreth 59 shkrime i takojnë kinematografisë dhe 32 muzikës. Ky vit, në ngjarjet e tij me ndikim në kulturë dhe arte, shënon konferencën kushtuar folkloristikës, vendimin e Plenumit të dytë të KQPPSH “Mbi krijimin e Akademisë së Shkencave”, Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, vijimin e thellimit të *frymës së partishme*<sup>13</sup>, si kusht i domosdoshëm për të rritur nivelin artistik të veprave si dhe kujdesit që duhet t’i kushtohet edukimit të të rinjve përmes letërsisë.<sup>14</sup>



12 Gj. Zheji, “Kritika dhe teoria”, *Drita*, 1972, 12 mars, f.1-2, nr.11

13 D. Dilaveri, “Thellimi i frymës së partishme, kusht i domosdoshëm për vepra me nivel të lartë ideo-artistik”, *Drita*, 1972, 30 korrik, f.1-2, nr.31

14 “Personaliteti i rinisë të fitojë më shumë vënd në letërsi”, *Drita*, 1972, 13 shkurt, f. 1-2 nr.7 ; Gj. Shkurtaj, “Për një trajtim më të gjerë të problemeve të rinisë në dramaturgj”, *Drita*, 1972, 26 mars, f. 7, nr.13 ; A. Ndini, “Për edukimin ideo-estetik të rinisë”, *Drita*, 1972, 21 maj, f.2, nr.21

Si në të paktat shkrime në numrat e këtij viti gjendet edhe ndonjë artikull me interesin e marrëdhënies që ndërton lexuesi me shkrimtarin, urat e bashkimit shpirtëror "për shkrimtarin e realizmit socialist që u drejtohet masave në emër të idealeve më të larta dhe që synon të përçojë tek lexuesi me krijimin e vet shqetësimin e vet, shqetësimin e shoqërisë e njëkohësisht edhe të dobishmen e të bukurën e njëkohësisht këto ura janë jetike...."<sup>15</sup>

### Viti 1973

Viti 1973 në gazetën "Drita" pasqyron këtë situatë:



Janë një numër i madh artikujsh kritikë që mbulojnë letërsinë në veçanti, por edhe artet e tjera. Veç 334 artikujve që trajtojnë letërsinë shqipe dhe atë botërore, janë dhe 88 të tjerë që mbulojnë teatrin dhe kinematografinë, artet dhe kulturën në përgjithësi. Në ligjërimin kritik del sërish, me përqendrim e forcë, çështja e "novatorizmit",<sup>16</sup> e cila tashmë i rri në krah problematikës së rreziqeve që vijnë nga modernizmi.<sup>17</sup> Disa artikuj që e shfaqin ripozicionimin e termit novatorizëm dhe këtë përballje janë: "Disa çështje të traditës dhe të novatorizmit në letërsinë tonë", "Karakterit spekulativ i të ashtuquajturave 'kërkime novatore'", "Patologji e 'novatorizmit'", "Degjenerimi revizionist i letërsisë në BRSS", "Modernizmi-shprehje e degjenerimit të kulturës

<sup>15</sup> T. Laço, "Shkrimtari dhe lexuesi", *Drita*, 1972, 12 nëndor, f.1-2, nr.43

<sup>16</sup> J. Bulo, "Tradicionalja, novatorja dhe format e pasqyrimin epik të jetës", *Drita*, 1973, 17 qershor. f. 4.; K. Bihiku, "Disa çështje të traditës dhe të novatorizmit në letërsinë tonë", *Drita*, 1973, 1 korrik, f. 3-4. F. Kongoli, "Karakterit spekulativ i të ashtuquajturave "kërkime novator", *Drita*, 1973, 15 korrik. f. 6-7; J. Xoxa. "Patologji e "novatorizmit", *Drita*, 1973, 12 gusht, f. 3-4.

<sup>17</sup> "Degjenerimi revizionist i letërsisë në BRSS", *Drita*, 1973, 21 janar, f. 15. (nga letërsia e huaj); A. Uçi, "Modernizmi - shprehje e degjenerimit të kulturës artistike borgjeze", *Drita*, 1973, 3 qershor, f.14-16.; L. Hana, "Mbi disa aspekte të degjenerimit borgjez të letërsisë dhe artit në Poloni", *Drita*, 1973, 7 janar, f.15-16. (nga arti në vendet e huaja); M. Xhaxhiu, "Rruga letrare e Shollohovit nga lëkundjet deri në kursin revizionist", *Drita*, 1973, 4 shkurt, f.14-15.;11 shkurt, f.14-15; 18 shkurt, f.14

artistike borgjeze”, “Mbi disa aspekte të degjenerimit borgjez të letërsisë dhe artit në Poloni”, “Rruga letrare e Shollohovit nga lëkundjet deri në kursin revizionist” etj. Ruhet në mënyrë të qëndrueshme raporti i dominancës së shkrimeve kritike që merren me letërsinë shqipe ndaj atyre botërore. Grafiku i mëposhtëm (nr.15) vizualizon të dhënat:

Diagramë 15- viti 1975



Shkrime të rëndësishme në numra të gazetës lidhen ngushtësisht me rezultatet e raportit të Plenumit të 4 të KQ të PPSH, ku fjala e Enver Hoxhës thekson se shkarjet në letërsi dhe arte lidhen me punën e pamjaftueshme të Komitetit të Partisë ku militojnë shkrimtarë. Këtu shigjetohet dhe kryqëzohet Fadil Paçrami për pikëpamjet e tij të huaja<sup>18</sup>liberalo-anarkiste, si deviator i djathtë. Njësoj ndodh edhe me Todi Lubonjën, i cili etiketohet si element antipartiak e ndjekës i rrugës së partigoditjes.

### Viti 1974

Faqet e gazetës “Drita” rezonojnë fort me agjendën politike të vitit si edhe me zbërthimin e mëtejshëm të kësaj agjende në artikuj më shumë programatikë sesa kritikë. Është viti pas “furtunës” së Plenumit IV dhe ligjërimi kritik bart gjurmë që shkojnë nga droja dhe autocensura deri në himnizim e pllakatizëm. Partishmëria në letërsi dhe arte konfirmohet si sinonim i novatorizmit dhe kryefjalë e realizmit socialist në dukje *sui generis*. Citimet nga fjalimet e Enver Hoxhës rrijnë në themel të aparatit shkencor të shkrimit kritik.

Ky vit shënon mbledhjen e Plenumit të V të Komitetit Qendror të PPSH, zgjedhjet e Kuvendit Popullor dhe “Miratimin njëzëri të popullit të kandidatëve për deputetë”.<sup>19</sup>


18 “Raporti i Plenumit të KQ të PPSH-së”, 26 qershor 1973. Fjala e mbajtur nga Enver Hoxha.

19 “Mbledhja e Plenumit V të KQ të PPSH”, nr.3 fq.1, 28 korrik; “Dita e zgjedhjeve të Kuvendit Popullor”, nr.31, fq.1, 4 gusht; “Populli miraton njëzëri kandidatët për deputetë në Kuvendin Popullor”, nr.34 fq.1, 25 gusht.



Grafiku i mëposhtëm (nr.16) ilustron raportin mes kritikës kushtuar letërsisë shqipe dhe asaj botërore, referuar artikujve të shqyrtuar të listës bibliografike në fund.

Diagramë 16- 1974



#### Viti 1975

Gjatë këtij viti, në faqet e gazetës janë botuar rreth 123 artikuj kritikë, ndër të cilët 115 i kushtohen letërsisë shqipe. Nga këta, 23 kanë në fokus botimet poetike të letërsisë shqipe, 84 trajtojnë çështje teorike apo recensione të prozës sonë dhe vetëm

8 artikuj u kushtohen krijimeve dramatike. Nga ana tjetër, kritika letërsisë botërore përfaqësohet me 8 artikuj, nga të cilët 5 përqendrohen në gjinitë poetike dhe 3 të tjerët në çështje të prozës ose të teorisë së letërsisë.

Mbisundon në shkrimet kritike të këtij viti theksimi i poezisë optimiste, i partishmërisë në krijimtari, i rolit militant të kritikës. Ndër shkrimet mbi letërsinë botërore, poezia palestineze, argjentinase, italiane, dhe ajo e Majakovskit zenë kryet e vendit. Edhe kritikët që marrin përsipër rolin vlerësues janë po të njëjtët emra: Koço Bihiku, Vehbi Bala, Klara Kodra, Dhimitër Shuteriqi, Bashkim Kuçuku, Razi Brahimi etj. Kritika rikonfirmon rolin e saj në shërbim të formatimit të lexuesit sipas modelit shtetëror, siç vërehet qartë që në titullin e artikullit të K. Bihikut: "Për një kritikë shkencore, konkrete dhe bindëse".<sup>20</sup>

Në përmbyllje të këtij pesëvjeçari, nisur nga statistikatat e botimit të teksteve letrare në faqet e gazetës "Drita", del në pah fakti se periudha 1971-1975 vijon prirjen e periudhës së mëparshme, duke i lënë hapësirë më të madhe poezisë, si gjini mbizotëruese, me temat kryesore kushtuar devocionit për "Partinë"<sup>21,22</sup>, "Republikës"<sup>23,24</sup>, "Atdheut"<sup>25</sup>, LANÇ-it<sup>26,27</sup>. Por, nga ana tjetër, krahasuar me dhjetëvjeçarin 1961-1970, proza në këtë fazë nis të fitojë terren.

Artikujt teorikë dhe kritikë letrarë paraqesin refuzimin ideologjik që i bëhet artit perëndimor. *Modernizmi* konsiderohet pa mëdyshje e me këmbëngulje të amplifikuar si çoroditës i artit dhe i letërsisë revizioniste<sup>28</sup>, *rrymat dekadente* si ekzistencializmi<sup>29</sup>, ekspresionizmi<sup>30</sup> dhe hermetizmi<sup>31</sup> gjykohen si shprehje të krizës dhe si fryte pa jetë të një letërsie e shoqërie kapitaliste në kalbëzim. Kryefjalë e këtij ligjërimi kritik e teorik mbi letërsinë botërore të ashtuquajtur "moderniste e dekadente", mbetet përparësia e përhershme e metodës dhe e letërsisë së realizmit socialist, e vetmja letërsi e angazhuar në shërbim të pushtetit komunist. Përparësinë ia jep formulimi i pandryshueshëm: *Arti, gjithmonë, i ka shërbyer një klase, dhe se paanshmëria e tij e liria e krijimit është veçse një iluzion*<sup>32</sup>.

20 Bihiku, Koço. "Për një kritikë shkencore, konkrete dhe bindëse", *Drita*, nr.4, f.3; "Të forcojmë bazën metodologjike të kritikës letraro-artistike", nr.5, f.13; "Për koncepte të shëndosha marksiste leniniste të procesit krijues", nr. 8, f.1,3

21 Kraja, Fadil. "Partisë", *Drita*, 28 tetor, 1975

22 Gjetja, Ndoc. "Partisë", *Drita*, 9 nëntor, 1975

23 Çaçi, Aleks. "Republikës", *Drita*, 12 janar, 1975

24 Qafëzezi, Luan. "Republikës", *Drita*, 6 janar, 1974

25 Marku, Rudolf. "Atdheu", *Drita*, 31 mars, 1974

26 "Dëshmorit", *Drita*, 14 janar, 1973

27 Bilbili, Xhahil. "Bisedime partizanësh", *Drita*, 24 korrik, 1975

28 Murati, Shaban. "Modernizmi çoroditës i artit dhe i letërsisë revizioniste", *Drita*, 3 mars, 1974

29 Begu, Tomor. "Ekzistencializmi-shprehje e krizës së letërsisë së sotme moderniste", *Drita*, 13 korrik, 1973

30 Buza, Kujtim. "Ekspresionizmi-pjellë e dekadentizmit", *Drita*, 26 gusht, 1973

31 Varfi, Andrea. "Hermetizmi- fryt pa jetë i shoqërisë kapitaliste në kalbëzim", *Drita*, 30 shtator 1973

32 Murati, Shaban. "Iluzioni i 'artit të paanshëm' dhe i 'lirisë së krijimit'", *Drita*, 14 shtator, 1975

Grafiku i artikujve kritikë të botuar gjatë këtij pesëvjeçari, ilustruar në grafikun nr.17, tregon qartë misionin formatues dhe kornizues që i ishte dhënë kritikës, sidomos përgjatë vitit 1973.

*Diagramë 17*



## Rast studimi

### **Risemantizimi i termit “novatorizëm” dhe realizmi socialist “sui generis”**

Viti 1973 shenjon një piketë të re në historinë e marrëdhënies së letërsisë dhe arteve shqiptare me institucionet e pushtetit, duke kulmuar me zhvillimet e nxitura nga Plenumi IV i PPSH, pasojat e të cilit do të jenë afatgjata për thujt një dekadë në të gjithë jetën artistike e kulturore dhe në ligjërimin kritik. Megjithatë, ashtu siç kishte ndodhur edhe më parë, rruga për te Plenumi IV (mbajtur në qershor), kishte nisur të shtrohej më herët nga një varg i gjatë fjalimesh, raportesh, diskutimesh, shkrimesh kritike, denoncimesh e autokritikash të imponuara. Regëtimi i beftë i një farë lirie artistike skenike gjatë netëve plot shkëlqim të Festivalit të 11 të RTSH-së, ritmi modern i shumë këngëve, gjestikulacioni dhe finesat në interpretim, veshja dhe paraqitja disi më e çlirët dhe më afër modës së fundit të Perëndimit, e bënë të vetëdijshme Partinë e Punës se në gjirin e artistëve e të artit shqiptar “fryma revolucionare”, dogma marksiste-leniniste dhe “partishmëria” nuk përbënin më një fill ideologjik primar. Aspekte të formës, shprehje të intimes, grimca mode dhe individualizimi, harmoni të reja dhe vargje më lirike, të shfaqura së bashku gjatë ditëve të fundit të dhjetorit të vitit 1972 (ndonëse të nxitura, apo së paku të lejuara po nga figura të larta partiake e të pushtetit), u perceptuan si dukuri të një rrezikshmërie të lartë ideore që meritonte jo vetëm ndëshkim, por sidomos një fushatë të strukturuar denoncimesh, zbulimesh, kërcënimesh, imponimesh dhe kufizimesh, për të mbërritur në një kontroll kapilar të pashembullt, skajshmërisht ksenofob, mbytës e çoroditës, të endur më së shumti me kundërshti logjike dhe ashpërsi ideologjike. Për regjimin nuk duhej humbur asnjë ditë kohë për të ndërhyrë e vepruar.

Për rrjedhojë, që në ditët e para të janarit, në fjalën e tij gjatë mbledhjes së Komitetit Qendror të PPSH-së, me titullin kuptimplotë “Si duhet kuptuar dhe si duhet luftuar rrethimi imperialisto-revizionist i vendit tonë dhe efekti i presionit të tij mbi ne”, Enver Hoxha jep direktivën e qartë të erës së ndryshimit dhe forcimit të censurës mbi artet dhe letërsinë. Edhe në diskutimet e pak ditëve më pas në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor ai do të përforcojë idenë e një ndarjeje të qartë të artit shqiptar nga ai “i huaj” e aq më tepër atij kapitalisto-revizionist. “Kultura jonë

socialiste nuk duhet të shartohet me ato forma", paralajmëron ai, duke shtjelluar më tej se "zhvillimin e kulturës dhe të artit ne duhet ta bëjmë në bazë të principeve të vijës së Partisë sonë, në bazë të ideologjisë sonë M-L, në luftë kundër çdo ndikimi të huaj ideologjik, sepse duhet të ruhemi nga depërtimi i ideologjisë së huaj në jetën shpirtërore të shoqërisë sonë në ndërgjegjen e njerëzve tanë".

Nga maja e piramidës së pushtetit, direktivat dhe paralajmërimet do të shtrihen pa humbur kohë në institucionet e jetës artistike dhe letrare në vend, veçanërisht në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, në të cilën, krahas mbledhjeve me natyrë të hapur politike do të imponohen edhe diskutime të gjera të bazuara mbi gjinitë e llojet letrare, konkretisht për poezinë, tregimin, romanin, dramën, vetë kritikën etj., për të hetuar deri në imtësi e në thellësi problemet, gabimet e fajet ideologjike që, në mos do të ndëshkoheshin, do të duhej të korrigoreshin me përpikmëri metodike e ideologjike. Për të siguruar këtë proces "vetë-korrigjimi" parashikohet edhe një instrumentar parandalues ose ndëshkues, siç janë edhe detyrimi për kontroll paraprak të krijimtarisë artistike ende të pabotuar nga hallkat e zinxhirit të gjatë kontrollues të redaksive (recenzent, redaktor, ekspertizë, kolegji etj.) si dhe përfshirja e kontrollit punëtor, qoftë në botime konkrete, qoftë në shtypshkronja si shprehje e vullnetit dhe vigjencës së shëndoshë të masës<sup>1</sup> për ruajtjen dhe forcimin e vijës ideologjike në letërsi dhe arte.

Gazeta "Drita", organ dhe tribunë e LSHA-së, luan rolin e saj të rëndësishëm në komunikimin masiv, për të realizuar këtë ndërmjetësim publik mes udhëzimeve e direktivave të pushtetit dhe aktantëve të përfshirë në teatrin e madh të propagandës përmes kulturës dhe artit. Krahas botimit të dokumentave partiake (raporte, fjalime të mbledhjeve, Plenumit etj.) – procedurë e zakonshme për çdo periodik në vend, në faqet e gazetës "Drita" përvijohet reagimi i detyruar e i ngritur në sistem i vetë aktantëve letrarë dhe artistikë të cilët gjenden nën trysni e kërcënim.

Ky sistem, duke zbërthyer direktivat e përcjella përmes ligjërimit politik, do të synonte konkretisht:

- evidentimin dhe qortimin e ndikimeve nga letërsitë dhe artet e huaja moderne;
- demaskimin e dekadencës së letërsisë të ashtuquajtur moderniste botërore;
- teorizimin e një koncepti të ri të realizmit-socialist *sui generis*, realizuar përmes disa koncepteve bazë si: novatorizëm në brendi, traditë kombëtare, karakter popullor e socialist, partishmëri komuniste;
- krijimin e një kanoni të ri letrar shqiptar të realizmit-socialist, të qëruar nga veprat e kontaminuara prej "shfaqjeve liberale".

### **Evidentimi dhe qortimi i ndikimeve nga letërsitë dhe artet e huaja moderne**

1 Në *Drita*, 29 prill, 1973, hapet rubrika "Mendime të masave për letërsinë dhe artin".

zë fill me diskutimet në LSHA për Festivalin e 11-të dhe më tej do të shtrihet në të gjitha gjinitë e artit e të letërsisë. Artikuj si "Mbi disa probleme të këngës që dolën në Festivalin e 11-të në RTSh", "Pulsi i jetës dhe pulsi i poezisë", "Kur mungon njohja e jetës", "Probleme aktuale të dramaturgjisë sonë", "Romani *Dimri i vetmisë së madhe*", "Konceptet, teorizimet edhe veprat e një dramëfabrikuesi", "Traditat në regjizurë dhe disa shfaqje moderniste", si dhe raporti i D. Agollit në Plenumin e Lidhjes, gjurmojnë dhe ilustrojnë me vepra e autorë dukuritë dhe pamjet e përkufizuara paraprakisht si "ndikime të huaja" në dokumentat partiake. Në këto artikuj pohohet ndër të tjera se "megjithëse poezia jonë në përgjithësi është e pastër, kohët e fundit janë vënë re disa shfaqje të dëmshme, si pasojë e ndikimeve të huaja moderniste, siç janë errësimi me tendencë i përmbajtjes, hermetizimi, fragmentarizimi, bredhja formaliste pas metaforave absurde. Kjo vjen nga përgatitja e pamjaftueshme ideologjike, teorike e kulture e poetëve që janë ndikuar dhe e redaktorëve që i kanë botuar. Sado të pakta që janë këto ndikime, e shqetësojnë opinionin publik, pasi e vështirësojnë shijimin e poezisë në popull dhe dobësojnë veprimin e saj edukues".<sup>2</sup> Edhe në diskutimet në LSHA mbi poezinë, (25 mars) janë kritikuar rëndë të ashtuquajturat "shfaqje të hermetizimit", "abuzimet në përdorimin e figuracionit", "subjektet e paqarta e të shpërndara", "mendimet e errta", "ngushtësitë tematike", "varfërimi i përmbajtjes", "mënjanimi nga temat e mëdha e të rëndësishme" etj. Ndërsa vetë poeti D. Agolli shprehej se në poezinë e viteve të fundit "u dobësuan e u shmangën temat mëdha qytetare si vendi i njeriut në shoqërinë socialiste, domethënia e përmbysjeve të mëdha, formimi i njeriut të një tipi të ri, dramaciteti dhe epika e kohës sonë; se intimitja u kuptua si diçka personale; dashuria u trajtua e shkëputur nga realiteti, psikologjia e botëkuptimi ynë; se jo rrallë në këtë frymë i këndohet emancipimit të ndjenjave të femrës dhe jo personalitetit të saj etj." Nuk mungojnë as *mea culpa*-t në trajtë autokritike<sup>3</sup> e pohimi pa kushtë të gabimeve, por as denoncimet konkrete të autorëve që do të shpallen armiq si për shembull Fadil Paçrami, Todi Lubonja, Mihallaq Luarasi etj.

### **Demaskimi i dekadencës së letërsisë të ashtuquajtur moderniste botërore**

synon zberthimin dhe divulgimin e tipareve të letërsisë moderniste si një rrezik dhe kërcënim për artin e realizmit-socialist. Këtë instrumentar konceptesh ideologjike e letrare artikujt e gazetës "Drita" ua mëkojnë "masave punonjëse" të cilave u është besuar detyra e vigjëlinit për pastërtinë e artit socialist. Artikuj si "Një apogjet i

<sup>2</sup> Agolli, Dritëro. "Pulsi i jetës dhe pulsi i poezisë", *Drita*, 11 mars, nr.10, 1973

<sup>3</sup> "Ne, shoku Enver, si luftëtarë dhe qytetarë të socializmit, po bëjmë përpjekje serioze për të gjetur në veprat artistike dhe në mendimet tona [...] shfaqjet e ndikimeve të huaja borgjeze dhe revizioniste [...]. Qëllimi ynë është që t'i shkulim nga rrënjët sepse trashja e tyre vë në rrezik fatet e realizmit socialist", në "Letër që shkrintarët dhe artistët e qytetit të Tiranës ia drejtojnë shokut Enver Hoxha", *Drita*, 15 prill, 1973, f.1

borgjezisë, teatri absurd i Beketit"<sup>4</sup>, "Modernizmi - shprehje e degjenerimit të kulturës artistike"<sup>5</sup>, "Hermetizmi - fryt pa jetë i shoqërisë kapitaliste në kalbëzim"<sup>6</sup>, "Rrymat dekadente në letërsi, hallka të një zinxhiri"<sup>7</sup> rreken të farkëtojnë interpretimin ideologjik të kësaj letërsie, e cila, nga ana tjetër, mbetet pa lexim publik për shkak të ndalimit të saj institucional.

**Teorizimi i konceptit të ri për një realizëm - socialist *sui generis***, do të zhvillohet kryesisht në shkrimet programatike e metodike të kritikës zyrtare të realizmit-socialist në vend. Si zakonisht kjo kritikë do të zërthejë me instrumente dhe koncepte para-letrare dhe letrare direktivat e qarta ideologjiko-propagandistike të dala nga dokumentat e Partisë, e cila, nga ana e saj, ia thekson këtë detyrë funksionale kritikëve si farkëtues të metodës *sui generis* të realizmit-socialist. Ky qëndrim ndaj produktit letrar, si vijim rikrijues i metodës, është në koherencë me vetë natyrën e realizmit-socialist: një metodë udhëzuese për të shkruar një letërsi me përmbajtje e funksion ideologjik. Guri i themelit për këtë etapë të re do të jetë përsëri *novatorizmi*. Por tashmë termi dhe koncepti janë zbratur tërësisht nga kumti i mëparshëm (debati mbi traditën dhe novatorizmin i vitit 1961), ose më saktë, termi dhe koncepti i rifarkëtuar do të mvishen me një kuptim thuajse të kundërt me atë më të hershmin.<sup>8</sup> Nëse vetëm para një dekade novatorizmi në gjirin e realizmit socialist vinte si një kundërvënie ndaj traditës të ngurtësuar të fillimeve të realizmit-socialist, traditë e cila për mungesë të cilësisë artistike dhe atrofizimit po e humbiste potencialin e letërsisë dhe arteve si vektorë të propagandës, tashmë, i njëjti term shenjon rikthimin ngulmues të tradita, të karakteri popullor e kombëtar. Nëse në vitin 1961 novatorizmi propozonte një model të ri, përtej letërsisë shqipe, siç ishte ai i periudhës post-staliniste në BRSS, nëse propozonte qoftë edhe nën zë një përparësi të formës mbi përmbajtjen, duke filluar nga viti 1973 novatorizmi do të mbetet pa një model të sprovuar letrar, duke u bërë ai vetë një model i ndërtuar metodologjikisht, në të cilin përmbajtja apo brendia socialiste do të shenjojë novatorizmin e vërtetë.

Vetë koncepti i "traditës", më se "klasik" në vitin 1961, është zbratur nga tradicionalja kombëtare për t'u injektuar me nocione të reja si "karakter i popullor dhe socialist", "partishmëria komuniste" etj., të cilat shenjojnë me traditë vetë traditën e realizmit-socialist. Në thelb, novatorizmi i ri është një pohim i hapur i besnikërisë ndaj partisë dhe vijës së saj ideologjike për artet dhe letërsinë. Pjesë nga raporti kryesor i Plenumit IV botuar fill mbas mbylljes së punimeve të tij në faqen e parë të "Dritës", më 1 korrik, theksojnë që në titull se "Partishmëria komuniste

4 Velça, Kudret. "Një apogjet i borgjezisë, teatri absurd i Beketit", *Drita*, nr.12. 25 mars, 1973, f.14-15

5 Uçi, Alfred. "Modernizmi – shprehje e degjenerimit të kulturës artistike", *Drita*, 3 qershor, 1973, f.14-16

6 Varfi, Andrea. "Hermetizimi – fryt pa jetë i shoqërisë kapitaliste në kalbëzim", *Drita*, 30 shtator, f.14-15

7 Xhaxhiu, Myzafer. "Rrymat dekadente në letërsi, hallka të një zinxhiri", *Drita*, 21 tetor, 1973, f.14-15

8 Për më tepër shih *casus-in* për novatorizmin në vitin 1961.

[është] parim i madh i letërsisë dhe arteve tona", duke shtjelluar më tej premiset e novatorizmit të ri:

"Çështja e traditës dhe novatorizmit, është shtruar disa herë nga Partia dhe shoku Enver; është tërhequr vëmendja për një interpretim të drejtë dialektik të këtyre dy aspekteve dhe për ta kuptuar novatorizmin, në radhë të parë, në përmbajtje. Edhe në këtë plenum u shtrua përsëri ky problem dhe u tha me të drejtë se tradita duhet marrë në kompleksin e vet, tradita e vjetër demokratike e përparimtare dhe tradita e re e realizmit socialist. Janë vënë re shfaqje të nënfvleftësimit të traditës, të ndarjes mekanike e artificiale të krijimtarisë letrare artistike sipas dekadave, janë dhënë mendime se gjoja letërsia dhe arti i vërtetë fillon në vitet '60 e të tjera teorizime të huaja e dritëshkurtra, të cilat duhen flakur si të papajftueshme me vijën e partisë. Tradita jonë e re e realizmit socialist, veprat e sotme të shëndosha që krijojnë besnikërisht shkrimtarë dhe artistë më me përvojë e më të rinj janë një mbështetje e madhe e jona në luftën për t'iu kundërvënë aktivisht mendimeve të huaja çoroditëse, shfaqjeve liberale apo konservatore."<sup>9</sup>

Parashtresave në trajtë direktive të faqes së parë do t'u përgjigjet me besnikëri edhe artikulli teorizues i Koço Bihikut, titulluar "Disa çështje të traditës dhe të novatorizmit në letërsinë tonë", në të cilin ripohohen të njëjtat teza, vërejtje, qortime e nocione, por me një gjuhë kritike edhe më të egër e kërcënuese:

"Të pohosh se në art novatorizmi lind pa marrë e shfrytëzuar arritjet më të mira të përparshme, do të thotë të pranosh se zhvillimi mund të vijë edhe nga hiçi, gjë që është absurde. Kur artisti këput çdo lidhje me traditën, siç bëjnë modernistët, atëherë përveç eksperimentimit të zbrazët ose veprave pa qëllim dhe pa kuptim, asnjëherë s'fitohet. Pak a shumë një gjë e tillë u ndodh disa poetëve të rinj, të cilët, siç mëson përvoja e shkrimtarëve të çdo epoke, do të mbështeteshin diku në hapat e para të rrugës së tyre krijuese, do të mbështeteshin në disa tradita, por duke mos dashur që ta gjenin këtë mbështetje në traditën e pasur të poezisë sonë, i hodhën sytë gjetkë, në tradita të tjera, të papranueshme për artin tonë, çka kuptohet, i çoi në rrugën e imitimit të modeleve letrare të artit dekadent formalist."<sup>10</sup>

Më tej artikulli sjell edhe përkufizimin e qartë të novatorizmit të ri dhe sidomos përcaktimin e kriterëve të tij: "Në kuptimin dhe zgjidhjen e drejtë të problemit të së resë dhe të së vjetrës në art, rëndësi të madhe ka çështja e kriterëve të novatorizmit. Novatorizëm kemi atëherë kur shkrimtarët e zgjerojnë sferën e pasqyrimin të jetës në letërsi, duke pasqyruar në veprat e tyre konflikte dhe procese të reja të realitetit, duke ndriçuar në mënyrë sa më të plotë jetën shpirtërore të shoqërisë sonë, dhe, kur gjatë zgjidhjes së kësaj detyre, ata përpunojnë forma dhe mjete të reja të pasqyrimin dhe të shprehjes artistike. Megjithatë, faktet tregojnë se novatorizmi para së gjithash

9 "Partishmëria komuniste, parim i madh i letërsisë dhe arteve tona", *Drita*, nr.26, 1 korrik, 1973, fq.1

10 "Disa çështje të traditës dhe të novatorizmit në letërsinë tonë", po aty, f.3

duhet parë në brendinë e tij [...]”<sup>11</sup>. Tashmë, ta formuloje novatorizmin nga premisa të formës e të mjeteve stilistike, do të përbënte pa kurrëfarë mëdyshje një gabim dhe një dëm ndaj letërsisë së realizmit socialist.

Gjatë vitit 1973, në faqet e gazetës "Drita" nuk do të rreshtin artikujt kritikë e teorizues që kanë marrë përsipër të amplifikojnë rikonceptimin e novatorizmit, i cili mbetet në thelb një nga alibitë më të përdorshme për të intimiduar autorë, vepra e të cilëve bart shenja të një kërkimi formal e stilistikor më të shprehur, si dhe për të ngritur një kanon të ri, shprehje besnike të direktivave e udhëzimeve të vijueshme. Përmendim këtu një varg artikujsh të tillë si: "Vazhdimësia e zhvillimit të letërsisë dhe kalimet e reja cilësore"<sup>12</sup>, "Brendia socialiste, tipari dallues e më esencial i letërsisë e i arteve tona"<sup>13</sup>, "Karakterit spekulativ i të ashtuquajturave 'Kërkime novatore'"<sup>14</sup>, "Patologji e novatorizmit"<sup>15</sup>, "Rreth përmbajtjes dhe përdorimit të drejtë të figurave letrare"<sup>16</sup> etj.

Diskutimi nëse metafora kishte apo jo një karakter klasor në një nga artikujt e Razi Brahimit, shenjon qartë absurdin në të cilin u gjend jeta artistike e kulturore gjatë kësaj dekade.

**Krijimi i një kanoni të ri letrar shqiptar të realizmit-socialist**, të qëruar nga veprat e kontaminuara prej "shfaqjeve liberale" shenjon një zbrazje të "bibliotekës së realizmit-socialist" të viteve të fundit nga tituj dhe autorë të njohur, për t'u mbushur me vepra dhe emra të rinj, disa prej të cilëve thuajse anonimë, si dhe tematika të reja (novatore socialiste). Kriteri përzgjedhës i këtij kanoni të ri është besnikëria ndaj dogmës së re të sapokonceptualizuar të realizmit-socialist *sui generis*. Faqet e gazetës pushtohen nga krijime me tematikë thellësisht të orientuar dhe të detyruar nga kanoni tematik, si për shembull, cikli i poezive kushtuar hekurudhës Elbasan-Prrenjas, skicë-reportazhet "Frymëzime nga Fushë-Miloti" etj. Në shumë raste, poetë të njohur e të kritikuar tashmë për lirikën e tyre intime u drejtohen temave pllakat të diktuar nga kanoni i ri, si për shembull, poezitë "Punëtorët e ndërtimit", "V.F.L.P." të Xhevahir Spahiut. Kjo sindromë do të marrë trajta freudiane në poezinë "Partia" të poetit Ndoc Papeleka:

*Çami damarët  
E gjakun shikojua  
Gjaku im si yti.*

11 Idem

12 Brahimi, Razi. "Vazhdimësia e zhvillimit të letërsisë dhe kalimet e reja cilësore", *Drita*, 10 qershor, 1973

13 "Brendia socialiste, tipari dallues e më esencial i letërsisë e i arteve tona", po aty, 15 korrik,

14 Kongoli, Fatos. "Karakterit spekulativ i të ashtuquajturave 'Kërkime novatore'", po aty

15 Xoxa, Jakov. "Patologji e novatorizmit", po aty, 12 gusht

16 Malo, Foto. "Rreth përmbajtjes dhe përdorimit të drejtë të figurave letrare", po aty, 2 dhjetor

*Çami damarët  
Gjaku im  
Do të vijë në damarët e tu  
Si avulli i kthyer në shi  
Te deti.*

*Çami damarët  
Prej tyre do të gurrojë dashuri  
Dhe këngë do të pikojnë  
Për ty!*

Këtu do të ndikojë edhe qarkullimi "vullnetar" i shkrimtarëve dhe artistëve në gjirin e klasës punëtore dhe popullit punonjës.<sup>17</sup> Në letrën e hapur drejtuar shokut Enver Hoxha, botuar në faqen e parë të gazetës "Drita", më datë 15 prill, me titullin "Me besim, optimizëm e frymëzim revolucionar ne do të krijojmë vepra të tjera të bukura, të denja për Partinë, për popullin, për komunizimin" janë shpallur programi editorial dhe kriteret tematiko-ideologjike të kanonit të ri në përmbushje të udhëzimeve të Partisë.

---

<sup>17</sup> "Letër që shkrimtarët dhe artistët e qytetit të Tiranës ia drejtajnë shokut Enver Hoxha", *Drita*, 15 prill, 1973, f.1



## 5.4 Vitet 1976-1980

### Viti 1976

Agjenda politike e ditës, e pasqyruar si gjithmonë edhe në faqet e gazetës Drita, përkon këtë vit me formalizimin dhe vënin nën kontroll edhe ligjërisht të letërsisë dhe arteve, duke propozuar në projektkushtetutën e re (e cila do të miratohet në fund të dhjetorit 1976) nene specifike mbi rregullimin përmbajtësor dhe formal të tyre. Në numri 4 të gazetës,<sup>1</sup> ndërsa botohet projektkushtetuta e re, spikat neni 35, në të cilin gjendet ky formulim: *letërsia dhe arti u përmbahen idealeve të socializmit e të komunizmit dhe përshkohen nga fryma kombëtare dhe popullore*. E njëjta frymë përcillet edhe nga fjalime të shumta partiake, të botuara si kryeartikuj dhe editoriale, të cilat fokusohen edhe më shumë në kërkesën për thellimin e luftës së klasave dhe të revolucionarizimit të letërsisë. Në fjalimin e nëntorit të Enver Hoxhës dalin qartë në pah detyrat dhe detyrimet e letërsisë dhe artit socialist: *Pasqyrimi më i mirë i disa temave të mëdha ... si ajo e rolit hegjezon të klasës punëtore në shoqëri... e shndërrimeve të fshatit tonë socialist, e forcës revolucionarizuese të komunistëve, trajtimi i temave kardinale dhe i momenteve kyçe të historisë së popullit tonë dhe sidomos të Luftës Nacionalçlirimtare e të revolucionit socialist, janë kërkesë e domosdoshme për t'i bërë letërsinë e artet tona edhe më revolucionare*.<sup>2</sup>

Kjo kërkesë për t'i bërë edhe më revolucionare letërsinë dhe artin përkon edhe me vitin jubilar të 35-vjetorit të themelimit të Partisë. Faqet e gazetës Drita bëhen tribunë e frymës politike e jubilarë.

Prodhimi kinematografik shqiptar, teksa konsolidohet me prodhime të Kinostudios "Shqipëria e re", ushqehet kryesisht nga veprat letrare. Tetë artikuj që përqendrohen në Festivalin e parë të kinematografisë shqiptare<sup>3</sup> e vënë në dukje edhe këtë prirej.

### Viti 1977

Në pjesën më të madhe të artikujve teoriko-programatikë të gazetës "Drita" vijohet me orientimin dhe formatimin e realizmit socialist *sui generis*, përmes

1 Drita, 5 janar 1976, nr.4

2 Hoxha, Enver. "Partia ka treguar kujdes të vazhdueshëm për lulëzimin e kulturës, letërsisë dhe arteve tona", Drita, 7 nëntor 1976

3 Drita, nr.6, 18 prill 1976

një pakete udhëzuese e urdhëruese mbi mënyrën e "të bërit" letërsi. Një pikëtë e rëndësishme në këtë stad është edhe Plenimi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, punimet e të cilit paraqiten në numrin 12 të gazetës.<sup>4</sup> Në aspektin e kërkesave për rritje të cilësisë së letërsisë tanimë kërkohet forcimi i realizmit në prozë.<sup>5</sup> Artikujt kritikë këtë vit theksojnë forcën e njeriut komunist<sup>6</sup> dhe luftën e klasave<sup>7</sup>, forcimin e revolucionarizmit dhe kujdesin që duhet të ketë arti nga rreziqet që vijnë prej revizionizmit.<sup>8</sup>

Duke ruajtur të njëjtin fokus të marrëdhënies së ngushtë të letërsisë shqipe me prodhimin kinematografik shqiptar, po këtë vit, në numrin 16-të shenjohe krentimi i 30-vjetorit të kinematografisë, këtij arti të ri por gjithnjë "premtues" për propagandën e masave.

### Viti 1978

Ky është një vit që karakterizohet nga më pak artikuj teoriko-propagandistikë, edhe pse ata me natyrë revolucionarizuese nuk mungojnë. Artikujt kritikë marrin kryesisht në shqyrtim vepra konkrete, lidhur me prozën e poezinë. Prirja politike për izolim dhe përqendrim vetëm në hapësirën kulturore shtetërore të mbikontrolluar shqiptare vërehet qartë në shumicën dërrmuese të tyre, në kontrast të dukshëm me artikujt mbi letërsinë "dekadente e moderniste" botërore të viteve 1973-1975, ku demaskimi i liberalizimit kërkonte një artikulum të fortë e të dendur. Gjatë vitit 1978, në gazetën Drita, nga 66 artikuj kritikë të marrë në shqyrtim, 65 syresh kanë në fokus vepra të letërsisë shqipe.

### Viti 1979

Artikujt e këtij viti i kushtohen prozës dhe çështjeve teorike mbi zhvillimin e letërsisë si dhe rolin që duhet të vijoje të luajë kritika, së cilës i kërkohet sërish e me këmbëngulje të gjurmëve e të vërë në pah praninë ose jo të luftës së klasave në çdo vepër letrare. Një tregues i pakundërshtueshëm i nënshtrimit tërësor të shkrimit dhe mendimit kritik ndaj direktivave, udhëzimeve dhe urdhërësive partiake është

4 *Drita*, nr.12, 20 mars 1977

5 Kodra, Klara. "Forcimi i realizmit në prozën tonë". *Drita*, 1977, 16 janar, f.3,13

6 Lezha, Neki.; Kuçuku, Bashkim. "Forca revolucionarizuese e komunistit në jetë dhe në letërsi. (Përpara Plenumit të Lidhjes me temën: Letërsia dhe arti të ndjekin ritmet e zhvillimit të shoqërisë sonë). *Drita*, 1977, 27 shkurt, f.1, 3; Cerga, Agim. "Rreth figurës së komunistit në krijimtarinë letrare". *Drita*, 1977, 27 mars, f.3.

7 "Të pasqyrojmë më gjerë luftën e klasave. (Në prag të Plenumit të Lidhjes me temën: Letërsia dhe arti të ndjekin ritmet e zhvillimit të shoqërisë sonë) /Bisedë në redaksi/, *Drita*, 1977, 6 mars. f. 3-4; Shaplo, Dalan. "Lufta e klasave dhe forcimi i karakterit kombëtar të artit tonë" *Drita*, 1977, 24 korrik, f.1,14; Fico, Agron. "Disa aspekte të luftës së klasave në prozën e shkurtër popullore" (Traditat tona) /Anekdodat popullore/, *Drita*, 1977, 18 dhjetor, f.12

8 Kadare, Ismail. "Zhvillimi i letërsisë sonë në luftë me presionin borgjez e revizionist." *Drita*, 1977, 27 mars, f.13-14; H. Sinani. "Mjerimi i poezisë", *Drita*, 1977, 25 dhjetor, f.16

detyrimi por edhe rendja e vulnetshme e kritikës mbas një sistemi të dendur citimesh nga veprat e udhëheqësve partiakë ose të atyre të dogmës markiste-leniniste. Citimi i mëposhtëm e shfaq më së miri këtë prirje: "Lufta e klasave është prekur dukshëm në veprën e shokut Enver Hoxha, ku tregohet se vend të veçantë zë partia jonë dhe shoku Enver, në çështjen e luftës së klasave në frontin ideologjik si një nga drejtimet kryesore....", apo "Partia na ka dhënë analiza, përgjithësim, direktiva dhe mësim të çmuara për letërsinë dhe artin. (...) Shkrimtarët, sipas Enver Hoxhës, kanë dhënë mjaft kontribute duke shkruar vepra të bazuara nga marksizmi-leninist, pra janë besnikë dhe kanë krijuar vepra me një brendi të shëndoshë.(...) Arti me përmbajtje socialiste dhe revolucionare, të cilat pëlqehen nga masa".<sup>9</sup> Nga ana tjetër, kjo kritikë pretendon rritje të nivelit artistik.<sup>10</sup>



Ekranizimi kinematografik i veprave letrare të letërsisë shqipe të realizimit socialist vijon të theksohet si një mjet edhe më efikas se vetë letërsia në funksion të propagandimit. Shumë prej artikujve të kësaj periudhe e theksojnë fuqishëm këtë marrëdhënie funksionale e preferenciale të letërsisë me kinematografinë. Edhe instrumentari i analizës kritike të kinematografisë gjurmon të njëjtat elemente të medtodës së realizmit socialist si karakteri kombëtar, karakteri heroik, heroi pozitiv, njeriu i ri socialist etj.<sup>11</sup>

Viti 1980

Ky vit shënon 35-vjetorin e krijimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, jubile që do të shoqërohet në muajin tetor nga zhvillimi i punimeve të Plenumit të Lidhjes. Shumë artikuj kritikë do t'u kushtojnë vëmendje filmave

9 Mitrojorgji, Pipi. "Lufta e klasave dhe krijimtaria artistike", *Drita*, f.1-3, nr.3

10 "Të ngremë më lart nivelin ideartistik të botimeve", *Drita*, f.2, nr.5, 4 shkurt

11 "E vërteta heroike e luftës në kuadrot e një filmi, 'Vajzat me kordele të kuqe'", 18 mars; "Konsolidimi dhe thellimi i karakterit kombëtar në filmin tonë artistik, *Drita*, 29 prill; Filmi 'Vajzat tekstiliste', *Drita*, 20 maj, Filmi "Mysafiri; Filmi "Koncert i vitit 1936". Gjeneral Gramofoni (Për një portret gjithnjë të freskët në kinematografitë tonë); Ilir Keko, Filmi artistik "Ballë për ballë"; Filmi artistik 'Radiostacioni', skenar i Ismail Kadare.


të Kinostudios "Shqipëria e re", si për shembull: "Radiostacioni", "Përballimi", "Besniku i partisë", "Mësonjëtorja", "Këshilltarët", "Yjet e netëve", "Liri a vdekje", "Yje mbi Drin", "Ne vinim nga lufta", "Lulëkuqet mbi mure", "Gjeneral Gramofoni", "Në pyjet me borë ka jetë" etj. Përmbajtja e këtyre filmave përkon saktësisht me topikat e kërkuara e të imponuara me synim të qartë propagandistik.

Tani e tutje edukimi i masave me propagandën e realizmit socialist kryhet suksesshëm edhe nga kinemaja, e cila për nga potenciali i saj funksional ka nisur të marrë përparësi ndaj letërsisë. Praktikata e punës me filmin shtrihen edhe në ambientin e pjesëmarrjeve kompetitive jashtë vendit, si p.sh. në Festivalin e 10-të Ndërkombëtar të filmit në Salerno. Por, referencat e kritikës teorike mbeten të pandryshueshme.<sup>12</sup>



Në përfundim të këtij 10-vjeçari, pamja e artikujve kritikë të shqyrtuar zërthehet sipas grafikut më poshtë (nr.18):

*Diagramë 18 - Artikuj kritikë mbi letërsinë shqipe dhe botërore, 1970-1980*



<sup>12</sup> Xhaka, Qemal. "Frederik Engelsi mbi thelbin ideologjik klasor të letërsisë e arteve", *Drita*, f.12, nr.47

Ndërsa prirja e shkrimeve kritike, në total, ka këtë zhvillim:

*Diagramë 19 – Prirja e shkrimeve kritike, 1971-1980*





## 5.5 Vitet 1981-1990

### Viti 1981

Artikujt kritikë të botuar gjatë këtij viti shfaqin prirjen e përhershme të parafabrikimit të formave dhe toposeve letrare. Duke i dhënë përparësi funksionit “edukues” të letërsisë, kritika do t’i mëshojë kalitjes së zhanreve më moderne por edhe më të receptueshme dhe me potencial më të madh ndikimi masiv<sup>1</sup> siç është proza dhe llojet e saj: romani, novela, tregimi.

Në këtë linjë, edhe Plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve këtë vit diskuton për arritjet e romanit dhe mbi rrugët se si të përmirësohet cilësia e tij.<sup>2</sup> Nga afro 109 artikuj kritikë që i përkasin vitit 1981, 101 janë për letërsinë shqipe, nga të cilët 18 i kushtohen poezisë, 1 dramës dhe 82 prozës dhe çështjeve teorike e ideologjike që lidhen me vetë letërsinë. Nga ana tjetër, letërsia botërore preket në 4 artikuj kushtuar poezisë e po aq kushtuar prozës.

Përsa i takon poezisë, kritika i mëshon thellimit të realizmit në poezi, duke e zhveshur kështu poezinë nga misteri i saj<sup>3</sup>, por paradoksisht duke e parë këtë direktivë si mundësi për të rritur cilësinë poetike. Duke mos e tradhëtuar në asnjë rast konceptin e letërsisë si pasqyrim të realitetit dhe idenë marksiste të progresit të pandalshëm të realitetit socialist, kritika vë në krahasim me ritëm të njëjtë përmirësimin e “cilësisë së jetës” me “cilësinë e procesit krijues”.<sup>4</sup>

### Viti 1982

Gjatë vitit 1982 kryefjalë të kritikës për letërsinë janë: *epoka socialiste, diskutimet nëpër degët e Lidhjes në vend dhe cilësia e letërsisë*. Artikulli i parë shkruhet për raportin e arteve me epokën socialiste, i vlerësuar i rëndësishëm në optikën e D. Agolli<sup>5</sup>. Fokusi i kritikës mban përgjatë muajve pasqyrimin e zhvillimeve të mbledhjeve e

---

1 H. Zenel. “Letërsia dhe artet- Armë të Partisë për edukimin e njeriut të ri”, *Drita*, 25 tetor, f.3

2 “Arritjet e romanit tonë, detyrat për ngritjen e cilësisë ideoartistike”, 27 nëntor f.4,15.; D. Agolli “Romani në arritjet dhe kërkimet e tij të vazhdueshme”, 27 nëntor f.4, 15

3 Londo, Bardhyl. “Thellim i frymës realiste në poezi”, *Drita* 13 janar, f.3

4 Abazi, Zh. “Zhvillimet cilësore të jetës dhe procesi krijues”, *Drita*, 8 shkurt, f.3

5 Agolli, Dritëro. “Epoka socialiste dhe artet”, *Drita*, 1982, 31 janar, f.1,3; Brahimi, Razi. “Realiteti bashkëkohor dhe brendia socialiste” (Në letërsi dhe art), *Drita*, 1982, 14 shkurt, f.1,13; Kadare, Ismail. “Kompletimi i tablosë së epokës socialiste-detyrë e letërsisë dhe e arteve tona” (Diskutim në Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, *Drita*, 1982, 18 prill, f.5-6

analizave vjetore të degëve të Lidhjes mbi diskutimet rreth cilësisë së letërsisë.<sup>6</sup> Nga ana tjetër, ngjarja më e rëndësishme e këtij viti, me ndikim të drejtpërdrejt në procesin krijues e vlerësues letrar është Plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.<sup>7</sup> Si në raportin e mbajtur nga Dritëro Agolli, ashtu dhe në diskutimet e të pranishmëve, nga të cilët veçojmë atë të Dalan Shapllon, ndërkohë që theksohet nevoja imperative për trajtim më të thellë të temave të aktualitetit socialist, me në krye heroin punëtor, si dhe nevoja për t'iu shmangur subjektivitetit të kritikës, e gjykuar kjo e fundit si e ndikuar prej famës dhe suksesit të shkrimtarëve të njohur, thelbi i tyre mbetet një sulm i porositur ndaj novelës "Nëpunësi i pallatit të ëndrrave" të Ismail Kadaresë. Në leximin alegorik që nxit kjo vepër, ka spikatur potenciali i saj i rrezikshëm për të parë sistemin nën dritën e një tiranie. Agolli pyet: "termat, "ndikime të huaja", "depërtim", "izolim", "kritere bazë", të cilat i ironizon autori, cilës kohë e cilit vend, cilit shtet e cilit sistem shoqëror i takojnë? Kjo është tepër e errët dhe problemi ndërlikohet"<sup>8</sup>. Për D. Shapllon, "trajtimi i simboleve e alegorive kërkon masën e vet dhe duhet bërë kur është i novojshtëm për një përgjithësim dhe për të trajtuar problemin në përmasa filozofike [...]. Kur alegoria është e errët dalin probleme të ndërlikuara si te kjo novelë, ku bëhet fjalë për një institucion imagjinar të vëzhgimit të ndërgjegjes popullore dhe për një gjendje shpirtërore të shtypur e të gjymtuar të njeriut pa e vendosur në kohë, me pozicion të turbullut të autorit, që shpie në kuptime të gabuara, sepse nuk del qartë kujt i drejtohet dhe çfarë mbron"<sup>9</sup>.

Kritika në përgjithësi, e cila ze vendin kryesor në faqet e gazetës Drita gjatë këtij viti, krahasuar me produktin letrar, udhëzohet dhe trumpeton se lufta, arritjet e jetës socialiste, temat e mëdha të aktualitetit<sup>10</sup> duhet të jenë tema frymëzimi për letërsinë shqipe. Letërsia duhet të ndjekë jetën socialiste. Edhe vetë shkrimtarët

6 "Cilësia e krijimtarisë kërkon edhe më shumë kulturë". (Në degët e Lidhjes) /Nga mbledhjet për analizat vjetore të degëve të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në rrethe, *Drita*, 1982, 14 shkurt, f. 2,4; "Përfunduan analizat vjetore". (Në degët e Lidhjes), *Drita*, 1982, 21 shkurt, f. 2, 13.; Ramiz Alia. "Rritja e cilësisë - detyrë themelore e letërsisë dhe e arteve." (Fjala e shokut Ramiz Alia, anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH mbajtur në Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë), *Zëri i popullit, Bashkimi, Drita*, 1982, 21 mars; Dritëro Agolli. "Letërsia dhe artet tona drejt një hopi të ri cilësor". (Nga referati i shokut Dritëro Agolli, mbajtur në Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, *Drita*, 1982, 21 mars, f.1, 6-12; "Cilësia në krijimtari kërkon shije të shëndosha dhe kulturë të gjerë." (Bisedë në redaksi, që zhvilloi redaktori ynë Bashkim Kuçuku me kritikët: Dalan Shapllon e Foto Malo dhe shkrimtarët Ruzhdi Pulaha e Vath Koreshi), *Drita*, 1982, 24 tetor, f.3,14; "Cilësia në qendër të vëmendjes. (Përpara analizave të punës vjetore) (Mbi veprimtarinë e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe e degëve të saj në të gjitha rrethet e vendit), *Drita*, 1982, 26 dhjetor, f.1,13

7 "Në Plenumin e Lidhjes. Plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë", *Drita*, 1982, 21 mars, f.1, 13,14.


8 Nga referati i shokut Dritëro Agolli, mbajtur në Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, *Drita*, 1982, 21 mars, f.10; "Cilësia në krijimtari kërkon shije të shëndosha dhe kulturë të gjerë."

9 Dalan Shapllon, "Për një raport më dialektik midis frymës socialiste dhe originalitetit kombëtar", 28 mars, 1982, f. 3.

10 K. Buza. "Temat e mëdha të aktualitetit socialist në qendër të krijimtarisë", 14 qershor f.1,4; apo A. Cerga. "Nga pasuria jetësore te ajo artistike", 12 dhjetor, f.3

nuk humbasin rast për ta përforcuar idenë se vetë letërsia dhe artet e tjera e kanë për detyrë kompletimin e kësaj tabloje socialiste.<sup>11</sup> Edhe lexuesit janë bërë tashmë pjesë aktive e sistemit kritik, në përmbushje të direktivave edhe të Kongresit të 8-të të PPSH-së edhe të Plenumit të Lidhjes. Faqet e gazetës mbushën me mendime e opinione nga ushtarakë, mësues, punëtorë, kooperativistë etj. Nga 86 artikuj të marrë në shqyrtim, 85 janë për letërsinë shqipe. Nga këta, 17 për poezinë shqipe, 67 për prozën dhe çështjet teorike të letërsisë dhe vetëm 1 për dramën. Bie në sy prirja për të nxitur “talentet e reja” si me botimin në faqet e gazetës ashtu dhe në kornikat mbi rrethet letrare kudo nëpër Shqipëri.

### Viti 1983



Pozicionin dominant të kritikës ndaj prodhimit letrar e tregon qartë edhe numri i lartë i artikujve kritikë. Nga ky vit kemi përzgjedhur 197 artikuj të tillë. Direktiva për të forcuar gjinitë e prozës por edhe konsolidimi i një grupi prozatorësh shpjen në një dominancë të kritikës së prozës shqipe. Rreth 130 artikuj i kushtohen asaj, përfshirë edhe një numër artikujsh të teorisë së prozës së realizmit socialist. Ndërsa poezisë shqipe i kushtohen 36 artikuj, dramës shqipe 13. Vetëm 17 artikuj i kushtohen letërsisë botërore duke shenjuar prirjen e shfaqur mbas vitit 1975 të izolimit tërësor dhe autoreferencialitetit të letërsisë së realizimit socialist shqiptar *sui generis*. Në këtë rrugëtim të kritikës shqiptare, e vetmja mbështetje teorike ka mbetur literatura ideologjike marksiste<sup>12</sup> e partiake.

11 I. Kadare. “Kompletimi i tablosë së epokës socialiste- detyrë e letërsisë dhe arteve tona”, *Drita*, 18 prill f.5,6.

12 T. Çaushi. “Karakterit popullor i artit në konceptimin e Marksit”, *Drita*, 06.02.1983, f. 5; Xh. Abazi, “Aktualiteti i pikëpamjeve të Marksit mbi raportet e letërsisë me jetën”, *Drita*, 13.02.1983, f.5,13; B. Kosova. “Nga studimi i veprës së Marksit, kuptova veprat e mia”, *Drita*, 20.02.1983, f.14; L. Gjoni. “Mësimet e Stalinit për letërsinë dhe artin mbeten gjithnjë aktuale”, *Drita*, 06.03.1983, f.5; R. Brahimi. “Arti në kontekstin e përgjithshëm të veprës së Marksit”, *Drita*, 13.03.1983, f.3,4



Viti 1984

Kritika e këtij viti e analizon letërsinë shqipe në optikën e krijimit të një tradite të re e cila është formësuar prej udhëzimeve të drejta ideologjike.<sup>13</sup> Në raport me pesë vitet e mëparshme ndjehet një prani më e shtuar e artikujve kushtuar letërsisë botërore, me rreth 28, por mbizotërues janë artikujt kushtuar prozës dhe çështjeve teorike, si në letërsinë shqipe, dhe në atë botërore. Artikujt e tjerë mbulojnë botimet vendase (191). Duke u kujdesur për vijimësinë e një letërsie *sui generis*, vëmendja partiake përqendrohet jo vetëm në produktet letrare *de facto*, por edhe në evidentimin dhe edukimin paraprakisht të talenteve të reja, si edhe në edukimin e vazhdueshëm të shkrimtarëve dhe artistëve, duke propaganduar parimet e thjeshtësisë, modestisë, partishmërisë, revolucionarizmit, militantizmit,<sup>14</sup> komunizmit etj.

13 Uçi, Alfred. "Me formim ideologjik dhe kriter shkencorë", *Drita*, 24 prill, f.13; "Letërsia dhe arti ynë i ri- krijesë e revolucionit dhe e socializmit", f.3,4, 29 prill.

